

KROACIA:

ZHVILLIME TË CAKTUARA NË LËMIN E DREJTËSISË TRANZICIONALE

*Dhjetor 2006 **

Përmbledhje ekzekutive

I.	PROCEDURAT GJYQËSORE	6
A.	Tribunali i Hagës	6
i.	Ndryshimi i qëndrimit	9
ii.	Aktakuzat e ngritura të gjykatës për mospërfillje të gjykatës	12
iii.	Numri i aktakuzave të gjykatës të Tribunali i Hagës	13
B.	Gjykimet në gjykatat	14
i.	Ballafaqimi me krime	18
ii.	Mbrojtja e dëshmitarëve dhe shpërndarja e viktimave	22
iii.	Bashkëpunimi në mes të autoriteteve dhe efikasiteti hetues	24
II.	KËRKIMI I SË VËRTETËS	26
III.	KOMPENSIMI	28
A.	Kompensimi material	28
B.	Faljet publike	32
IV.	MEMORIALET	32
V.	VERIFIKIMI DHE REFORMAT TJERA INSTITUCIONALE	33
VI.	PËRFUNDIM	34

* Hulumtimet si dhe përpilimin e këtij raporti e kanë bërë Thierry Cruvellier dhe Marta Valiñas. E ka redaktuar dhe rishikuar Caitlin Reiger e ICTJ-së. Për ndihmën e dhënë falënderojmë edhe Suzana Grego, Vesna Teršelić, Nataša Kandić, Refik Hodžić, Matthew Steinberg, Bogdan Ivanišević dhe Tiasha Paliković. Ky raport është i treti me radhë në lëmin e drejtësinë kalimtare në ish Jugosllavi. Informata shtesë rreth historikut të konflikteve në rajon dhe zhvillimet krahasuese në Serbi dhe Mal të Zi dhe Bosnje dhe Hercegovinë mund të gjenden në raportet e mëparshme të publikuara në tetor të vitit 2004, që mund të merren në www.ictj.org. Qëllimi i secilit studim është i kufizuar dhe ka të bëjë me ofrimin e një pasqyre të temave të caktuara, e jo situatës së përgjithshme.

Përmbledhje ekzekutive

Që nga përfundimi i konfliktit në ish Jugosllavi, Kroacia ka kaluar nëpër një periudhë të ndryshimeve politike dhe përparimit ekonomik, si dhe ka bërë hapa të konsiderueshëm në drejtim të hyrjes në Bashkimin Evropian (BE). Sidoqoftë, trashëgimia e luftërave që u zhvilluan gjatë viteve të nëntëdhjeta është e dukshme dhe përderisa përpjekjet për të adresuar dhe zgjidhur çështjet që kanë dalë nga shkeljet e bëra në luftëra janë evidente, vendi ende ballafaqohet me pengesa të dukshme në përpjekjet e tij për t'u ballafaquar me të kaluarën.

Ky studim ofron një pasqyrë të disa nga çështjet kryesore si dhe zhvillimet e fundit në drejtësinë kalimtare në Kroaci. Ai përbën një pjesë të serisë e cila ka për qëllim të ofrojë informata dhe analiza për çështjet me të cilat ballafaqohen vendet në tranzicion. Studime të ngjashme janë publikuar për disa vende tjera të rajonit, para së gjithash për Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Serbinë dhe Malin e Zi.

Përfundimet e raportit janë përmbledhë sikurse vijon:

- *Ndjekjet penale para gjykatave ndërkombëtare.* Marrëdhëniet në mes të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavi (ICTY) dhe Kroacisë kanë qenë të tensionuara, para së gjithash të prishura për shkak të refuzimit të Kroacisë për ndjekjen penale të disa nga zyrtarët e lartë të ushtrisë së saj. Së fundi, një bashkëpunim i shtuar dhe arrestimi i pritur gjatë i Ante Gotovinės kanë përmirësuar marrëdhëniet e Kroacisë me Tribunalin si dhe në përgjithësi me bashkësinë ndërkombëtare. Sidoqoftë, reagimet e opinionit publik ndaj Tribunalit brenda Kroacisë mbesin negative për shkak të perceptimit se Tribunali është kundër Kroacisë. Kjo pavarësisht nga fakti se në shumicën e rasteve që janë sjellë para Tribunalit në lidhje me krimet e shkaktuara në territorin e Kroacisë kanë qenë të akuzuar serbët. Edhe pse nuk duket se ka mundësi të ketë transferime tjera të aktakuzave nga Tribunali për në Kroaci sipas Rregullës 11*bis*, roli i Tribunalit në ndjekjen penale të të dyshuarve për krime lufte para sistemit të gjyqësisë në Kroaci megjithatë mund të rritet nëse Tribunali vendos t'ia transferojë hetimet të cilat janë pjesërisht të kompletuara gjykatave në Kroaci si pjesë e strategjisë së tij përmblylëse.
- *Gjykimet para gjykatave vendore.* Sistemi gjyqësor i Kroacisë ka bërë përparime të dukshme në aftësinë dhe gatishmërinë e tij për t'u marrë me krimet e kryera gjatë luftës. Veçanërisht vlen të përmendet se është krijuar një dhomë e specializuar për t'u marrë me rastet e krimeve të luftës. Është vendosur një dispozitë e posaçme e cila mundëson transferimin e rasteve për në qendrat rajonale për ato raste kur është frikuar se mund të ketë anime në gjykatat lokale. Përveç kësaj në vitin 204, Kodi Penal i Kroacisë është amendamentuar për të inkorporuar doktrinën e përgjegjësisë së komandës si bazë për mbajtje të përgjegjësisë, kështu duke përforcuar edhe më tej kompetencat e gjyqësorit për të dënuar krimet e luftës. Më në fund, shtimi i bashkëpunimit në mes të shteteve ka ndikuar pozitivisht në efikasitetin e hetimeve. Sidoqoftë, brengë e

konsiderueshme mbetet: pohimi i vazhdueshëm për anime nga përkatësia etnike gjatë shqiptimit të masave, mbajtja e gjykimeve në mungesë të të akuzuarve, mungesa e mbrojtjes adekuate të dëshmitarëve, dhe përfaqësimi i pamjaftueshëm ligjor i viktimave.

- *Kërkimi i së vërtetës.* Mediat e pavarura dhe OJQ-të kanë luajtur rolin kyç në iniciativat për gjetjen e të vërtetës në Kroaci, duke ngritur kështu në debate publike çështjen e krimeve të kryera në të kaluarën. Në anën e saj, qeveria kroate ka bërë shumë përpjekje të kufizuara për të ekspozuar kështu zyrtarisht dhe për të ngritë vetëdijen për faktet që rrethojnë krimet e kryera kundër jokroatëve. Për më tepër, ekziston një mohim i vazhdueshëm i çfarëdo keqbërje në anën e armatës kroate dhe rolin e saj në spastrimet etnike të civilëve serbë. Në vend të kësaj, qëndrimi zyrtar përqendrohet në pohimin se lufta në Kroaci ka qenë luftë mbrojtëse dhe legjitime, sikurse edhe thuhet në “Deklaratën mbi luftën patriotike”, e cila është miratuar nga ana e parlamentit në tetor të vitit 2000.
- *Kompensimi.* Çështja e kompensimit në Kroaci ka qenë kryesisht e përbërë nga adresimi i shkeljeve të të drejtave pronësore meqë ato janë të ndërlidhura me kthimin e refugjatëve. Ka përfshirë masa sikurse janë kthimi dhe rindërtimi i pronës, si dhe krijimi i programeve të strehimit të drejtuar kah ish personat të cilët kanë pasur të drejtë shfrytëzimi/banimit. Politika e qeverisë në drejtim të personave që kanë pasur të drejtë shfrytëzimi/banimit është kritikuar ashpër nga organizatat e të drejtave të njeriut dhe ka qenë në gjyq në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Qeveria po ashtu ka bërë gjeste simbolike në formë të pranimit zyrtar të dhe kërkimin e faljes për të këqijat e bëra në të kaluarën, përfshirë edhe kërkim faljet e ndërsjella në mes të Kryetarit të Kroacisë, Stjepan Mesiç, dhe Kryetarit të Unionit Serbi dhe Mal i Zi, Svetozar Marovic, në shtator të vitit 2003.
- *Memorialet.* Në Kroaci janë ndërtuar disa memoriale, por të gjitha me përjashtimin e njëres janë ngritur për të nderuar viktimat kroate. Me përjashtime të rralla, memorialet më shumë janë ngritur për nder të fitores në “Luftën për atdheun” sesa kontribut njohjes së përbashkët të së kaluarës.
- *Procesi i verifikimit dhe reformat tjera institucionale.* Përderisa Kroacia ka bërë përpjekje në drejtim të reformave institucionale, nuk janë vendosur procedura formale të verifikimit për individët të cilët thuhet se kanë qenë të implikuar në shkeljet e të drejtave të njeriut në të kaluarën. Për më tepër, pavarësia e gjyqësorit vazhdon të jetë në pikëpyetje. Pakicat kombëtare vazhdojnë të jenë të nënperfaqësuar në gjyqësor, polici dhe forcat e armatosura gjë që, pasi të kombinohet me mosgatishmërinë e përgjithshme për të pranuar plotësisht krimet e kryera në emër të Kroacisë, kontribuon në mungesën e besimit civil në institucionet shtetërore, posaçërisht në mesin e bashkësive pakicë në Kroaci.

Puna hetimore e Tribunalit të Hagës në ndjekjen penale është duke u lehtësuar nga qëndrimi bashkëpunues si dhe gatishmëria dhe aftësia gjithmonë në rritje e gjykatave në Kroaci për të ndjekur penalisht kryesit e veprave penale gjatë kohës së luftës. Kjo

dukshëm ka kontribuar në drejtim të llogaridhënies për krimet e kryera në luftërat e Kroacisë. Përveç kësaj, angazhimi i vazhdueshëm i shoqërisë civile dhe mediave të pavarura ka bërë që keqtrajtimi i kaluar dhe ai i tanishëm i pakicës serbe të jetë në sytë e opinionit. Megjithatë, mbeten sfida të konsiderueshme dhe ato janë tregues i dështimit të rrënjësor për të pranuar në mënyrë përkatëse rolin e Kroacisë në shkeljet e bëra gjatë luftës. Politikat qeveritare në lidhje me kthimin e refugjatëve, mungesat e ndryshme në ndjekjen penale para gjykatave vendore, mungesa e reformës gjithëpërfshirëse institucionale dhe mungesa e kërkimit të së vërtetës e sponsoruar nga shteti dhe iniciativa për verifikimin e kandidatëve janë pengesa drejt ballafaqimit gjithëpërfshirës dhe kuptimplotë me të kaluarën.

HYRJE

Shpallja e pavarësisë së Kroacisë nga ish Jugosllavia në vitin 1991 është bërë pas zgjedhjeve të lira në vend, të mbajtura në vitin 1990. Kjo ka shkaktuar një reagim të dhunshëm nga grupet ushtarake dhe paramilitare serbe të mbështetura nga Beogradi, e që kryesisht kanë qenë në rajonin e Krajnës dhe Sllavonisë. Lufta shpërtheu në mes të forcave kroate dhe serbe në vitet 1991 – 1992, ndërsa në vitin 1995 rezultoi në 20,000 të vdekur ose të zhdukur që janë raportuar si dhe qindra mijëra persona të zhvendosur dhe refugjatë. Edhe pse armëpushimi ishte nënshkruar në vitin 1992 dhe pavarësia e Kroacisë ishte e njohur nga Bashkimi Evropian (BE) në të njëjtin vit, kjo nuk ka ndodhur deri në vitin 1995 kur Kroacia morri kontrollin e shumicës së territorit të saj të pjesës që ishte e kontrolluar nga serbët gjatë kohës së luftës – për afërsisht një të tretën e vendit. Kjo rimarrje e tokës është arritur me ekzodus masiv, në të shumtën e rasteve të dhunshëm, të mbi 300,000 serbëve të Kroacisë.

Konflikti në të cilin Kroacia ishte e përfshirë përfundoi në vitin 1995 me nënshkrimin e dy marrëveshjeve kryesore për paqe. E para, marrëveshja e Dejtonit, e cila zyrtarisht përfundoi luftën në Bosnjë dhe Hercegovinë, në të cilën ka qenë e përfshirë edhe Kroacia. E dyta, Marrëveshja e Erdutit rezultoi në krijimin e administratës së përkohshme të OKB-së në rajonin e Sllavonisë lindore. Kjo zgjati deri në vitin 1998, kur Kroacia mori sovranitetin e plotë mbi mbarë territorin.¹

Pas vdekjes së Presidentit kroat, Franjo Tugjman, në vitin 1999, i cili ishte në pushtet që nga shpallja e pavarësisë së shtetit, qeveria kaloi nga Unioni Demokratik Kroat i Tugjmanit (HDZ) në duart e Partisë Social Demokrate në zgjedhjet e vitit 2000. Megjithatë, në vitin 2003 HDZ-ja e ktheu pushtetin nën kryeministrin Ivo Sanader. Stipe Mesiq, i cili ishte figura kryesore në HDZ në vitin 1990 por që më vonë u largua nga partia për shkak të mospajtimeve me Tugjmanin, u zgjodh si president në vitin 2000 dhe u rizgjodh në vitin 2005.

Përmes zhvillimit ekonomik dhe pragmatizmit politik, Kroacia tejkaloi Bosnjën e Hercegovinën dhe Serbinë e Malin e Zi, duke treguar gatishmëri gjithmonë në rritje për të

¹ Rezoluta 1037 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, e miratuar në 15 janar të vitit 1966.

bashkëpunuar me këto dy shtete.² Kroacia ka një zhvillim ekonomik relativisht stabil dhe të konsiderueshëm, e përcjellur me hapje graduale ndaj Perëndimit, e që të dyja këto kanë qenë të stimuluar nga perspektiva e bashkimit me BE-në. Në tetor të vitit 2005, Kryeprokurorja e Tribunalit Ndërkombëtar Penal për krimet e kryera në ish Jugosllavi (TPNJ) theksoi se Kroacia ishte duke “bashkëpunuar plotësisht” me Tribunalin, e që kjo menjëherë nxiti bisedimet për përfshirjen e Kroacisë në BE.³ Dy muaj më vonë, arresti i të kërkuarit të kamotshëm nga Tribunali i Hagës, gjeneralit Ante Gotovina, në ishujt Kanarinë të Spanjës mënjanoi një nga pengesat kryesore në perceptimin se qeveria e Kroacisë bashkëpunon plotësisht me Perëndimin. Duke vepruar kështu, ata shtruan rrugën për marrëdhënie më të mira.

Pavarësisht nga këto zhvillime të suksesshme, mbetet një brengë e rëndësishme për procesin transitor të Kroacisë e që ka të bëjë me të kaluarën e saj. Gjykimi i të dyshuarve për krime lufte, në veçanti për krimet e bëra kundër serbëve të Kroacisë, është përplot me mangësi, dhe ka hasur në rezistencë të fortë nga partitë kryesore dhe shumica e popullatës. Perceptimi i Tribunalit të Hagës nga popullata është jo i kënaqshëm dhe se debatet publike për abuzimet gjatë kohës së luftës të kryera nga kroatët janë kufizuar. Edhe më tej mbetet një brengë, që ka të bëjë me anshmërinë etnike në gjyqësor.

Ky dokument ofron një pikëpamje të disa çështjeve madhore dhe zhvillimet e vonshme të drejtësisë tranzicionale në Kroaci. Përderisa fokusi kryesor është në gjykimin e krimeve të luftës në Tribunalin e Hagës dhe gjykatat kroate, dokumenti gjithashtu analizon përpjekjet e bëra për gjetjen e së të vërtetës (ose mungesën e saj), kompensimin e dëmit, si dhe reformat në institucionet relevante nga shteti kroat.

² Në qershor të vitit 2005, Presidentët e Kroacisë, Serbisë e Malit të Zi dhe Bosnjës e Hercegovinës nënshkruan një deklaratë të përbashkët për normalizimin dhe përforcimin e marrëdhënieve në mes të tre shteteve (për qëllimin e tyre të përbashkët të anëtarësimit në BE). Në këtë deklaratë ishte i përfshirë edhe bashkëpunimi i tyre për ndjekjen e krimeve të luftës, gjetja e së vërtetës për të kaluarën, promovimi i kthimit të refugjatëve dhe sigurimi i të drejtave të pakicave kombëtare. Shiko *Southeast European Times*, “Presidentët e BH, Kroacisë, Serbisë dhe Malit të Zi ngritin zërin për përforcim të paqes, duke u ballafaquar me konfliktin e fundit”, 28 qershor, 2005, http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/document/setimes/features/2005/06/28/feature-01.

Më pastaj është bërë një vizitë nga Presidenti Mesiq në Serbi e Mal të Zi në korrik të vitit 2005, gjatë të cilës ky dhe homologu i tij Svetozar Marović janë pajtuar të bashkëpunojnë për zgjidhjen e çështjeve të mbetura siç janë kthimi i refugjatëve, personat e zhdukur dhe çështja e pronësisë. Shiko “Presidenti i Kroacisë dhe Serbisë e Malit të Zi thonë që problemet e mbetura duhen zgjidhur”, *Southeast European Times*, 7 korrik, 2005, http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2005/07/07/feature-01.

³ Ndërsa, në tetor të vitit 2005, i është bërë e qartë prokurorit të ICTY-së së Kroacia e ka gjetur Gotovinën në Ishujt e Kanarinës dhe se është duke punuar me autoritetet Spanjolle për arrestimin e tij, vendimi i BE-së për të vazhduar bisedimet për pranim gjithashtu rastisën me marrëveshjen politike në të cilën Austria, kampion i Kroacisë përbrenda BE-së, u pajtua të heq kundërshtimet për bisedime për pranim në BE me Turqinë: Shih BBC “BE hap bisedimet Turqisë për anëtarësim”, 4 tetor 2005, mund të gjendet në: <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/4305500.stm>.

I. PROCEDURAT GJYQËSORE

A. Tribunali i Hagës

Edhe pse ka pasur përparim të konsiderueshëm në gjykimin e lëndëve që kanë të bëjnë me krimet e kryera gjatë luftës (të cilat do të shtjellohen më poshtë), ekzistenca e vazhdueshme e Tribunalit në Hagë ka vazhduar të ofroj kushte për zhvillimet që janë duke u bërë përbrenda Kroacisë. Marrëdhëniet në mes të Kroacisë dhe Tribunalit gjatë pesë viteve të fundit kanë qenë të tensionuara, në mes të së cilës ka qenë edhe gjykimi i disa eprorëve kroat, duke përfshirë këtu edhe gjeneralin Ante Gotovina. Duke u kërcënuar me refuzim BE-së për të filluar bisedimet, përderisa Kroacia të mos bashkëpunon plotësisht me Tribunalin e Hagës, autoritetet kroate gradualisht kanë adoptuar një qasje më pragmatike dhe ambivalente.

Derisa gjykimi i kroatëve ka nxitur reagimet e kroatëve ndaj gjykatës në Hagë, në shumicën e rasteve të sjella në Tribunalin e Hagës për krimet e kryera në territorin e Kroacisë janë të akuzuar serbët. Nga gjithsejtë 23 rastet që kishin të bëjnë me krimet e kryera në Kroaci dhe pas të gjitha vendimeve gjyqësore nga Tribunali i Hagës, 14 kanë qenë kundër serbëve (duke përfshirë edhe ata nga Bosnja dhe Serbia) në krahasim me 5 ndaj kroatëve.⁴

Disa nga rezultatet e tjera të rëndësishme në rastet kundër serbëve për krimet e bëra gjatë luftës në Kroaci përfshijnë: dorëzimi i gjeneral Pavle Strugarit⁵ dhe zëvendës-admiralit Miodrag Jokiq,⁶ që të dy ish eprorë në Armatën Jugosllave, për mos parandalimin dhe ndalimin e sulmit në Dubrovnik në fund të vitit 1991. Është gjithashtu me rëndësi të ceket dënimi kundërthënës me 13 vjet burgim i shqiptuar Milan Babiqit (dhe i mbështetur nga Dhoma e Apelit në vitin 2005) për pjesëmarrjen e tij në ndërmarrjen e përbashkët të krimit në vitin 1991 dhe 1992 që kishte për qëllim largimin e përhershëm me forcë të shumicës së popullatës joserbe nga përafërsisht një e treta e Kroacisë.⁷ Babiqi ishte presidenti i parë i Republikës së Krahinës Serbe⁸ të vetëshpallur. Ai u deklarua si fajtor për krimet kundër njerëzimit dhe persekutimit. Ai gjithashtu bashkëpunoi me Prokurorinë, ku ndër të tjera ka dëshmuar kundër ish Presidentit Jugosllav Slobodan Millosheviq. Edhe pse bashkëpunonte dhe kishte kërkuar falje publike për veprimet e tij, dënimi i shqiptuar ka qenë 11 vite më tepër se sa është kërkuar nga prokurori. Me 5 mars të vitit 2006, Babiqi bëri vetëvrasje në qelinë e tij të burgut në Hagë. Në kohën e vdekjes së tij, ai ishte duke dëshmuar kundër një të akuzuari tjetër, Millan Martiq – i cili kishte

⁴ Në bazë të informatave të disponueshme në faqen e internetit të Tribunalit të Hagës (www.un.org/icty), katër rastet e mbetura janë një shqiptar i Kroacisë dhe tre pjesëtar të Armatës Popullore të Jugosllavisë nga Mali i Zi.

⁵ *Prokurori kundër Pavle Strugar*, Rasti Nr. IT-01-42, Vendim i shkallës së parë, 31 janar i vitit 2005, Strugar është dënuar me 8 vite burgim.

⁶ *Prokurori kundër Miodrag Jokiq*, Rasti Nr. IT-01-42/1, Vendim i dhomës së Apelit, 30 gusht 2005. I akuzuari është deklaruar si fajtor dhe ishte dënuar me 7 vite burgim. Personi i tretë, Vlladimir Kovaçeviq, është akuzuar për sulm në Dubrovnik. Rasti i tij është ende në fazën e para-gjykimin. *Prokurori kundër Vlladimir Kovaçeviq*, rasti Nr. IT-01-42/2.

⁷ *Prokurori kundër Millan Babiq*, rasti Nr. IT-03-72, Vendim i Dhomës së Apelit, 18 korrik, 2005.

⁸ Rajoni i Krahinës është një vend në Kroacinë jugore.

zëvendësuar Babiqin si president i Krahinës Serbe – gjykimi i të cilit kishte filluar në fund të vitit 2005.⁹ Kjo konsiderohej një humbje e madhe për prokurorinë pasi që Babiqi pritej të dëshmonte gjithashtu në një numër të gjykimeve të ardhshme kundër të akuzuarve serb, duke përfshirë edhe Kreun e Shërbimit të Sigurimit Shtetëror të Serbisë, Jovica Stanishiq.¹⁰

Së bashku me rastin Martiq, gjykimi më famëkeq dhe ndoshta më i publikuar i Tribunalit të Hagës për Kroaci është rasti i “Treshes së Vukovarit”: Mille Mrkshiq, Miroslav Radiq dhe Veselin Shljivančanin, të gjithë ish eprorë të Armatës Popullore të Jugosllavisë (APJ). Këta tre persona ishin akuzuar për ekzekutimin në vitin 1991 e më shumë se 260 kroatëve të Kroacisë dhe joserbëve të tjerë në fermën Ovçara afër Vukovarit në Sllavinë Lindore.¹¹ Prokurori i Tribunalit të Hagës fillimisht kërkoi që rasti të zhvillohet në Kroaci ose Serbi e Mal të Zi, por në qershor të vitit 2005 vendosi ta tërheqë këtë kërkesë në mënyrë që të mbahet gjykimi në Hagë. Gjykatësit u pajtuan, duke ardhur në përfundim se “nuk është rast për transferim”.¹² Gjykimi i të tre të akuzuarve më në fund filloi në tetor të vitit 2005 – pas 10 vite padie ndaj tyre.¹³ Vendimi për të mos e transferuar rastin në rajon kishte, megjithatë, qenë si një mundësi e anashkaluar për disa arsye. OJQ-ja e stacionuar në Beograd, Qendra për të drejtën humanitare (HLC), avokoi për transfer duke u bazuar se Dhoma për krime të luftës në Serbi ishte veçse duke gjykuar kundër keqbërësve të drejtpërdrejtë të nivelit të ulët që kanë qenë të përfshirë në incidente të njëjta në Ovçara. HLC e Natasha Kandiçit argumentonte se gjykimi i Treshes së Vukovarit do të adresonte çështjen e përgjegjësisë së nivelit më të lartë komandues të APJ-së për krimet kundër viktimave kroate, të cilët mungonin në gjykimet vendore në Serbi. Rasti mund të kishte ofruar një rast për Serbinë dhe Kroacinë që ta thyejnë të kaluarën me bashkëpunim të vërtetë për t’iu përgjigjur shkeljeve të të drejtave të njeriut në të kaluarën. Për më tepër, për familjet e viktimave dhe publikun e gjerë kroat, Treshja e Vukovarit në Hage është transmetuar për publik më pak se sa do të ishte transmetuar po të ishte zhvilluar gjykimi në vend.¹⁴ Përderisa kjo ka mundur të zgjidhet përmes kontakteve më të shpeshta të Tribunalit të Hagës me publikun, edhe kjo nuk do të mund të zëvendëson ndikimin e gjyqimit të zhvilluar në Kroaci – në juridiksionin në të cilin janë bërë krimet.

⁹ *Prokurori kundër Millan Martiq*, rasti Nr. IT-95-11.

¹⁰ Vetëm pas një jave të vetëvrasjes së Babiqit, Slobodan Millosheviqi vdiq natyrshëm gjatë qëndrimit të tij në burgun e Tribunalit të Hagës, duke e shtuar kështu turpin e Tribunalit. Shih OSBE, “Raport: Reagimi i Kroacisë për vdekjet e Slobodan Millosheviqit dhe Millan Babiqit”, 12 mars 2006, fq. 1.

¹¹ *Prokurori kundër Mille Mrkshiq, Miroslav Radiq dhe Veselin Shljivančanin*, rasti Nr. IT-95-13/1-PT.

¹² *Prokurori kundër Mille Mrkshiq, Miroslav Radiq dhe Veselin Shljivančanin*, rasti Nr. IT-95-13/1-PT, Vendimi interpelancës së Prokurorit për të tërhequr interpelancën dhe kërkon transfer të gjyqimit të të akuzuarit sipas Rregullit 11 bis, 30 qershor 2005.

¹³ Mrkshiq u dorëzua në maj të vitit 2002 dhe dy të tjerët u arrestuan pas një viti. Në gjykimin më të rëndësishëm të bërë deri më atëherë nga gjykata e Serbisë, Oda e Krimeve të Luftës e Gjykatës së Qarkut me 12 dhjetor të vitit 2005, i dënoi 14 pjesëtarë të milicisë Serbe për masakrën në fermën Ovçara. Tetë nga të akuzuarit morën dënimin më të ashpër prej 20 vjet burgim dhe tre të tjerët me nga 15 vjet burgim. Dy nga 16 të akuzuarit ishin të liruar. Shih Reuters, “Serbia burgosi 14 persona për masakrën e Vukovarit të vitit 1991”, 12 dhjetor 2005.

¹⁴ Intervista e ICTY-së me Natasha Kandiç, qershor 2006.

Si shtesë për rastet e Tribunalit të Hagës që kanë të bëjnë me krimet e bëra në territorin kroat, janë një numër i rasteve që përfshijnë të akuzuarit boshnjakë të Kroacisë. Shumica e këtyre janë të lidhur me krimet e ndodhura në territorin e Bosnjës e Hercegovinës. Këtu përfshihet edhe rasti kundër “Xhokerëve”, një njësi speciale e forcave të policisë ushtarake të Këshillit të Mbrojtjes së Kroacisë, dhe rasti kundër Ivica Rajiq.¹⁵ Rastet e përfunduara kundër boshnjakëve të Kroacisë, ndër të tjera janë edhe të Tihmor Blashkiq,¹⁶ Zlatko Alleksovski,¹⁷ Dario Kordiq, Mario Çerkez¹⁸ dhe dy nga gjashtë të akuzuar në rastin *Kupreshkiq dhe të tjerët*.¹⁹

Por ishte padia kundër disa eprorëve të Armatës Kroate – në veçanti padia e vitit 2001 kundër gjeneralit Gotovina – që inspiroi reagimet më të fuqishme të popullatës në Kroaci dhe tensionet më serioze me Tribunalin e Hagës.²⁰ Në shkurt të vitit 2001 rreth 150,000 njerëz demonstruan në Split në përkrahje të gjeneralit Norac, duke kundërshtuar ekstradimin e tij në Tribunalin e Hagës për krimet e bëra në vendin afër Gospiqit në vitin 1993.²¹ Sikur Gotovina, Norac shihej si një hero luftime. Protestat përfunduan kur iu janë dhënë zotime se ai nuk ishte subjekt i padisë së Tribunalit të Hagës, edhe pse në fakt ai ishte i paditur nga autoritetet vendase.²² Megjithatë, disa muaj më vonë, në korrik të vitit 2001, Tribunali i Hagës publikoi padinë për krimet e kryera kundër serbëve të Kroacisë në “Operacioni Stuhia”. Pas njoftimit, demonstrata të konsiderueshme në mbështetje të Gotovinës janë mbajtur në mbarë vendin, kryesisht në Zagreb, Zarë dhe Split. Gotovina ishte temë për katër vite, e që për këtë periudhë kohore u bë “personi i tretë më i

¹⁵ *Prokurori kundër Ivica Rajiq*, rasti Nr. IT-95-12. Pasi që rasti i tij është propozuar t’i transferohet Odës për Krime të Luftës në Bosnje e Hercegovinë, Rajiq hyri në marrëveshjen për shfajësim me Prokurorinë në tetor të vitit 2005. Me 8 maj 2006, ai u dënua me 12 vite burgim nga ICTY.

¹⁶ *Prokurori kundër Tihomir Blashkiq*, rasti Nr. IT-95-14, Vendimi i Odës së Ankesave, 29 korrik 2004. I padituri u dorëzua në Tribunal në vitin 1995. Dënimi i tij u zvogëluar nga 45 vite burgim në nëntë vite nga Oda e Ankesave.

¹⁷ *Prokurori kundër Zlatko Aleksovski*, rasti Nr. IT-95-14/1, Vendimi i Odës së Ankesave, 24 mars 2000. Dënimi fillestar me dy vite e gjashtë muaj burgim u ndryshua në shtatë vite nga Oda e Ankesave.

¹⁸ *Prokurori kundër Dario Kordiq dhe Mario Çerkez*, rasti Nr. IT-95-14/2, Vendimi i Odës së Ankesave, 17 dhjetor 2004. Që të dy të pandehurit vullnetarisht u dorëzuan në Tribunal në tetor të vitit 1997 dhe u dënuan, respektivisht, 25 dhe 6 vite burgim për krime të luftës kundër njerëzimit. Ata fillimisht u dënuan së bashku me Tihomir Blashkiq dhe Zlatko Alleksovski për krimet e bëra në Luginën Llashva.

¹⁹ *Prokurori kundër Kupreshkiq et. al*, rasti Nr. IT-95-16, Vendim i Dhomës së Apelit, 23 tetor 2001. Dhoma e Apelit e ndryshoi dënimin kundër tre të akuzuarve dhe e zvogëloi atë për dy të tjerë, kryesisht në basë të asaj se Vendimi i shkallës së parë është mbështetur në identifikimin e provave të ofruara nga dëshmitarë të vetëm të cilët e vendosën të akuzuarin në vendin e krimet. Një nga të akuzuarit e parë është shpallur si i pafajshëm nga instanca e shkallës së parë.

²⁰ *Prokurori kundër Ante Gotovina*, rasti Nr. IT-01-45-I. Shih gjithashtu edhe *Prokurori kundër Rahim Ademi*, rasti Nr. IT-01-46-I.

²¹ Shih BBC, “Relli Masiv për të Dyshimtë për Krime Luftë”, 11 shkurt 2001, mund të gjendet në: <http://news.bbc.co.uk/1/hi/world/europe/1165540.stm> dhe BBC, “Protestuesit Kroat Ngritën Bllokada”, 12 shkurt 2001, gjendet në: <http://news.bbc.co.uk/1/hi/world/europe/1182987.stm>. Pro-Norac protestat ishin shënuar nga 15,000 demonstrues në mbështetje të gjykimin të krimeve të luftës dhe abuzimit të të drejtave të njeriut. BBC, “Mijëra Mbrojnë Sundimin e Ligjit të Kroacisë”, 19 shkurt 2001, mund të lexoni në: <http://news.bbc.co.uk/2/lo/world/europe/1179124.stm>

²² Norac dorëzohet vullnetarisht pas sigurisë që i ofrohet se mund të mos i dorëzohet ICTY-së. Ai është gjykuar dhe dënuar nga Gjykata e Qarkut të Rijekës. Pas pak kohe, ai është kërkuar nga ICTY dhe është dorëzuar për paraqitjen e tij fillestare. Rasti i tij tani është transferuar prapa në gjykatat vendore. Shih diskutimin në faqen 15 *infra*.

kërkuari” pas Radovan Karaxhiqit dhe Ratko Mlladiqit. Mosdorëzimi i Gotovinës tërhoqi me vete ndëshkime ndërkombëtare dhe ngadalësoi progresin e Kroacisë për hyrje në BE.²³ Këshilli i Sigurimit i OKB-së vazhdimisht kërkonte bashkëpunim të autoriteteve kroate për ta arrestuar të arratisurin.^{24, 25} Në një shembull tjetër të rezistencës së kroatëve ndaj Tribunalit të Hagës, autoritetet qeveritare refuzuan të ekstradojnë gjeneralin e akuzuar, Janko Bobetko, i cili eventualisht vdiq në Zagreb në vitin 2003. Në qershor të vitit 2005, Carla Del Ponte, Kryeprokurorja e Tribunalit të Hagës, shprehi iritimimin e saj ndaj mungesës për bashkëpunim së Kroacisë për sjelljen e të arratisurve para drejtësisë.

i. Ndryshimi i qëndrimit?

Në shkurt të vitit 2004, gjeneralët Ivan Čermak dhe Mladen Markač po ashtu janë akuzuar për krime kundër njerëzimit dhe shkelje të zakoneve dhe dokeve të luftës të kryera në vitin 1995 kundër popullatës serbe gjatë “Fushatës Stuhia”.²⁶ Sidoqoftë, që të dy të akuzuarit menjëherë iu dorëzuan Tribunalit. Duke marrë parasysh se ata u dorëzuan tre muaj pasi që partia nacionaliste HDZ u kthye në pushtet, dorëzimi i tyre është paraqitur si dëshmi e autoriteteve kroate për të bashkëpunuar me Tribunalin e Hagës, një vit para fillimit të bisedimeve për hyrje në Bashkimin Evropian.²⁷ Roli i qeverisë në këtë rast kryesisht është përbërë nga vënia në dispozicion e dokumentacionit dhe bindjes së të akuzuarve kroat për t’iu dorëzuar Tribunalit, përderisa këta do të ndihmonin me mbrojtjen.²⁸ Është edhe më e rëndësishme që në datën 3 tetor 2005, Kryeprokurorja e Tribunalit të Hagës Carla Del Ponte deklaroi se Kroacia tashme “po bashkëpunonte plotësisht” me Tribunalin.²⁹ Kjo deklaratë ishte një shenjë e hershme që çështja më e

²³ Shih për shembull, BBC News “SHB Shpërblejnë për të Arratisurin Kroat”, 9 tetor 2003: <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/3178836.stm>.

²⁴ Shih p.sh. Rezolutën e KS të OKB-së 1534 (2004) në të cilën KS “Rikonfirmon domosdoshmërinë e gjykimit të personave të kërkuar nga ICTY dhe përsërit këtë për të gjitha Shtetet, posaçërisht për Serbinë e Malin e Zi, Kroacinë dhe Bosnjën e Hercegovinën, dhe për Republikën Serbe përbrenda Bosnjës e Hercegovinës, të intensifikojnë bashkëpunimin dhe të ofrojnë gjithë ndihmën e nevojshme ICTY-së, posaçërisht për dorëzimin e Radovan Karaxhiqit dhe Ratko Mlladiqit, si dhe Ante Gotovinës dhe të të kërkuarve të tjerë në ICTY dhe bën thirrje për të gjithë të kërkuarit nga ICTY që të dorëzohen në ICTY”.

²⁵ Në qershor të vitit 2005, duke iu adresuar Këshillit të Sigurimit, Dell Ponte tha, “Për fat të keq, këto zhvillime pozitive [në ICTY] janë zbehur nga dështimet e vazhdueshme të autoriteteve relevante për të arrestuar dhe transferuar 10 të arratisur, duke përfshirë ata që janë cekur disa herë nga Këshilli i Sigurisë në Rezolutën e saj nën Kapitullin VII të Kartës. Për derisa Radovan Karaxhiq, Ratko Mlladiq dhe Ante Gotovina ia dalin t’i ikin drejtësisë dhe sfidojnë komunitetin ndërkombëtar, puna e Tribunalit do të jetë e pakryer”. Shih Deklaratë për Shtyp e ICTY-së, “Fjalimi i Karlla Dell Ponte, Prokurore e Tribunalit Ndërkombëtar të Krimeve për ish Jugosllavi, për Këshillin e Sigurisë”, 13 qershor 2005.

²⁶ *Prokurori kundër Ivan Čermak dhe Mladen Markač*, Lënda nr. IT-03-73. Momentalisht në fazën para fillimit të gjykimit.

²⁷ Human Rights Watch, “Raporti botëror për vitin 2005”, Jan. 2005, pp. 364-368.

²⁸ “Qeveria e Kroacisë është e bindur se pafajësia e tyre do të ofrojë të gjitha mjetet ligjore, teknike si dhe mjete tjera për mbrojtjen e tyre”, ka deklaruar Ministri i Drejtësisë i Kroacisë Vesna Shkare-Ozhbolt. BBC World, “Gjeneralët Kroat të Dorëzohen”, 8 mars 2004, <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/3542757>.

²⁹ Shiko për shembull, BBC, “BE nis bisedimet me Kroacinë”, 4 tetor 2005, <http://news.bbc.co.uk/1/hi/world/europe/4305682>. Kryeprokurorja e Tribunalit ka bërë një deklaratë të ngjashme më herët në vitin 2004, e cila është rishikuar në muajin nëntor në të njëjtin vit në një raport drejtuar Këshillit të Sigurimit të OKB-së në të cilin është thënë se Kroacia do të bashkëpunojë plotësisht vetëm kur gjenerali Gotovina t’i dorëzohet Tribunalit të Hagës.

ndjeshme në mes të Tribunalit dhe Kroacisë ishte gati për t'u zgjidhë. Dhe me të vërtet pas dy muajsh, në datën 7 dhjetor 2005, Ante Gotovina është arrestuar në ishujt Spanjolle të Kanarieve.³⁰

Edhe pse këto ngjarje duket se tregojnë ndryshimin e qëndrimit zyrtar ndaj Tribunalit të Hagës, disa faktorë tregojnë mëdyshjen në anën e HDZ-së sa i përket marrëdhënies të Kroacisë me Tribunalin e Hagës. Rritja e bashkëpunimit me Tribunalin ka siguruar përmirësimin e marrëdhënies me bashkësinë ndërkombëtare, por po ashtu ka vënë Qeverinë në konflikt me disa nga përkrahësit e saj, përfshirë këtu edhe veteranet e luftës. Rruga të cilën e ka ndjekur HDZ-ja pas arrestimit të Gotovinës ka reflektuar këtë situatë të palakmueshme. Sikurse edhe ka vërejtur një anëtar i Tribunalit të Hagës, “Kroacia fshihet nga Haga, por kjo iu kthye asaj me rastin e Gotovinës”. Për këtë arsye në javën e parë pas arrestimit të Gotovinës, një program i popullarizuar televiziv i cili kishte transmetuar kritika të ashpra për kryetarin e ndjerë Tugjman është ndaluar pasi që ka shkaktuar debate të nxehtë në parlament për dy ditë të plota. “Përshtypja ime është se [debati në parlament] ka pasur për qëllim që të tërheq vëmendjen prej rastit të Gotovinës dhe për të zvogëluar presionin. HDZ-ja toleron [Kryeministrin] Sanader por lehtë mund t'i kthehet ideologjisë së mëparshme të [saj]”, ka vërejtur një udhëheqës politik i opozitës.³¹ Kjo ngjarje sugjeron tentativën e HDZ-së që përsëri t'i përkushtohet trashëgimisë së Tugjmanit dhe kështu të qetësoj votuesit të cilët sipas të gjitha gjasave kishin ikur pas arrestimit të Gotovinës. Në një lëvizje të ngjashme, në datën 10 janar 2006, Kryeministri Ivo Sanader u takua me avokatët mbrojtës të të gjithë gjeneralëve të Kroacisë në mënyrë që të pajtohen për “një strategji të përbashkët” për mbrojtjen e tyre para Tribunalit të Hagës.³² Mënyra se si është raportuar rasti i Gotovinës në televizionin e Kroacisë në dhjetor të vitit 2005 edhe më tej ilustron paqëndrueshmërinë e marrëdhënies të autoriteteve të Kroacisë me Tribunalin e Hagës. Plotësisht ndryshe nga praktika e Bosnjës dhe Serbisë, dëgjimet në Tribunalin e Hagës, përfshirë këtu edhe gjykimin e Millosheviqit në përgjithësi nuk janë transmetuar plotësisht në televizionin kroat. Meqë televizioni mbetet burimi primar i informatave për shumë njerëz, ka pasur një injorim në masë më të madhe të Tribunalit të Hagës në Kroaci sesa në vendet tjera të rajonit.³³ Kjo u ka lehtësuar politikanëve të manipulojnë me perceptimet e publikut për

³⁰ Komunikatë për shtyp e Tribunalit të Hagës, “Fjalim nga Carla Del Ponte, Prokurore e Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish Jugosllavi drejtuar Këshillit të Sigurimit”, 15 dhjetor 2005.

³¹ Intervistë me ICTJ, Zagreb, 20 dhjetor 2005.

³² Shiko Transitions Online, “Beteja e fundit e Gotovinës”, 16 janar 2006. Në këtë botim është shkruar se “marrëveshja në mes të qeverisë dhe avokatëve mbrojtës para së gjithash përfshin edhe qasjen në të gjitha dokumentet zyrtare me urdhrat dh planet rreth veprimeve në vitin 1995”, dhe se “qeveria ka ndaluar disa ekspertë ligjor dhe historianë... në përpjekjen e saj për të hedhur poshtë pohimet e tribunalit se Operacioni Stuhia ka shkaktuar spastrimin etnik të popullsisë serbe nga Kroacia”. Më tutje përmend se “Ekipi mbrojtës i Gotovinës do të jetë i përbërë prej dy avokatëve nga Shtetet e Bashkuara Greg Kehoe dhe Luka Mišetić. Kehoe ka këshilluar tribunalin që ka gjykuar ish diktatorin irakian Saddam Hussein në Bagdad. Ai po ashtu ka shërbyer si prokuror në Tribunalin e Hagës në gjykimin e gjeneralit Kroat të Bosnjës Tihomir Blaškić”.

³³ Për shembull, në anketën e Komisionit Evropian të vitit 2005, në pyetjen se si Kroatët e perceptojnë BE-në, 80% thanë se marrin informatat e tyre nga televizioni, krahasuar me 44% nga shtypi ditor dhe 31% nga radio. Eurobarometri i Komisionit Evropian, “EuroBarometri 63.4: Raport Kombëtar: Përmbledhje ekzekutive – Kroacia”, Pranvera 2005, http://ec.europa.eu/public_opinion/archives/eb/eb63/eb63_exec_hr.pdf.

procesin gjyqësor.³⁴ “A tyre iu përshtatet për të mos e treguar Gjykatën”, ka bërë me dije një redaktor i gazetës lokale.³⁵ Megjithatë, çfarë është e jashtëzakonshme, dhe për arsye të cilat nuk janë shpjeguar qartë, paraqitja e parë e Gotovinës në Hagë, në datën 12 dhjetor është transmetuar drejtpërdrejtë dhe plotësisht në televizionin kroat.

Ngjashëm, edhe pse ka pasur disa indikacione të ndryshimit të mendimit publik në përgjithësi, popullata e Kroacisë në rastin më të mirë mbetet ambivalente për marrëdhënien e saj me Tribunalin e Hagës dhe në përgjithësi për ndëshkimet e krimeve të luftës. Një shenjë e përparimit mund të vërehet në faktin se janë duke u zvogëluar mbështetjet e publikut për të akuzuarit për krime lufte. Edhe pse demonstratat në mbështetje të gjeneralit Gotovina janë mbajtur pas arrestimit të tij – posaçërisht në qytetin e tij të Zares dhe në qytetin e Splitit, ku ai konsiderohet nga shumica si hero i luftës – shumë vëzhgues kombëtar dhe ndërkombëtar janë pajtuar se masa më e vogël në këtë rast dhe kohëzgjatja e protestave në Kroaci në muajin dhjetor 2005 (rreth 40,000 persona janë mbledhur në rrugët e Splitit, me siguri tre herë më pak sesa në vitin 2001) sugjerojnë evolucionin e kastës politike në vitet e fundit.³⁶ Sikurse është bërë me dije nga një zyrtar i lartë i Prokurorisë shtetërore, “në vitin 2000, ka pasur 150,000 njerëz të cilët kanë protestuar në mbështetje të Noracit. Sot ka pasur vetëm 50,000 për Gotovinën. Në vitin 2002, ka pasur demonstrata çdo ditë para gjykatës në lidhje me rastin *Lora*. Sot nuk ndodh asgjë. Gjërat po ndryshojnë krejtësisht”³⁷ Sidoqoftë, numri më i vogël i demonstruesve nuk është dëshmi e mjaftueshme e ndryshimeve të thella dhe të qëndrueshme, kështu që nuk ekziston një perceptim i qartë për mendimin publik në drejtim të përcaktimit të llogaridhënies për krimet e kryera në të kaluarën. Në muajin shkurt është themeluar fondi për mbrojtjen e kroatëve të akuzuar nga Tribunali i OKB-së.³⁸ Ky fondacion, me mbështetjen e një klubi lokal futbollistik ka raportuar se ka mbledhur 140,000 euro në muajin maj të vitit 2006.³⁹ Edhe familja e Gotovinës ka themeluar një fond ku njerëzit do të mund të kontribuonin për mbrojtjen e gjeneralit.⁴⁰

Përfundimi i punës së Tribunalit të Hagës tani është në horizont. “Strategjia për përfundimin e punës së gjykatës” e dorëzuar Këshillit të Sigurimit në vitin 2003, përmban një plan sipas të cilit Gjykata do të përfundojë të gjitha gjykimet deri në vitin 2008 ndërsa apelet deri në vitin 2010. Pavarësisht nga mbyllja e tij e afërt, ndikimi i tribunalit brenda Kroacisë është i theksuar nga ana e shoqërisë civile, mediave, gjyqësorit dhe partive

³⁴ Po ashtu i rëndësishëm në këtë kontekst është mënyra sensacionale se si shtypi ka shkruar për Tribunalin e Hagës – shumica e gazetave kryesore kroate përdorin ton ironik ose nënvlerësues kur shkruajnë për Tribunalin e Hagës, si dhe shpesh përqeshin Kryeprokuroren, gjyqtarët dhe personelin.

³⁵ Intervistë me ICTJ, 21 dhjetor 2005.

³⁶ “Ka qenë vështirë për t’u marrë me Gotovinën. Në vitin 2001, [udhëheqësit e HDZ-së] bënë thirrje për rrëzimin e qeverisë. Për katër vite kaluan nga kjo në madhështimin e Tribunalit të Hagës. Në vitin 2005, ata që organizuan demonstrata dhanë çfarëdo që mundën për ta bërë këtë punë të madhe, por megjithatë përgjigja ishte e vogël. Arsyeja kryesore ishte se HDZ-ja nuk i kishte organizuar ato. Por sidoqoftë, kjo tregon se vendi ka ecur përpara”, theksoi një udhëheqës i partisë opozitare. Intervistë me, Zagreb, 20 dhjetor 2005.

³⁷ Intervistë e ICTJ me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, Zagreb, 23 dhjetor 2005.

³⁸ Agence France Presse, “Dinamo e Zagrebit mbledh 140,000 euro për të dyshuarin për krime lufte”, 4 maj 2006.

³⁹ *Id.*

⁴⁰ *Id.*

politike, të cilat kanë avokuar tash e sa vite që shkeljet e të drejtave të njeriut në të kaluarën të pranohen dhe të ndjekën penalisht.⁴¹ Në njërin anë, duket se Tribunali i Hagës është perceptuar nga shumica si sfidë jolegjitime e pothuajse mënyrës gati të shenjtë të “Luftës për atdhe” që është mbjellë në Kroaci, si dhe pengesë e paarsyeshme në qasjen në Bashkimin Evropian.⁴² Në anën tjetër, gjykata u ka mundësuar atyre që kundërshtojnë perspektivën nacionaliste një instrument shumë të nevojshëm përmes të cilit çdoherë do të venë në pyetje diskursin zyrtar derisa shoqëria, ose autoritetet të mos tregojnë më shumë gatishmëri për të menduar në mënyrë kritike. Një udhëheqës i partisë politike e ka përmbledhë këtë në këtë mënyrë: “Edhe nëse njerëzit thonë se ka pasur shumë presion mbi Kroacinë, kjo prani konstante e ndjekjeve penale ka ndihmuar shumë në kufizimin e mitit të heroit. Tribunali i Hagës e ka mbajtur të hapur debatin [gjë që] besohet se nuk do të ndodhte [pa praninë e tij]. Institucionalisht ne nuk kemi qenë të fortë as sa duhet. Ka qenë e dobishme të kemi [ndjekje penale që janë bërë] jashtë [Kroacisë]”.⁴³

ii. Aktakuzat e ngritura nga Tribunali i Hagës për mospërfillje të gjykatës

Prapëseprapë, në vitin 2005 edhe një rast tjetër më i jashtëzakonshëm para Tribunalit të Hagës ka shkaktuar polemikë edhe brenda e edhe jashtë Kroacisë – kur Tribunali i Hagës ngriti aktakuzën kundër pesë gazetarëve kroat dhe ish kreut të Shërbimit të Fshehtë të Kroacisë për mospërfillje të gjykatës.⁴⁴ Të akuzuarit gjoja kanë zbuluar identitetin dhe dëshminë e dy dëshmitarëve të mbrojtur të Tribunalit në rastin Bllashkiq duke publikuar kështu emrat dhe deklaratat e tyre në gazetatat kroate. Të dy dëshmitarët iu janë nënshtruar urdhrorit për masa mbrojtëse dhe kanë dëshmuar në seancën e mbyllur. Edhe pse pati shumë pak njerëz që lëvduan publikimin e emrave të dëshmitarëve të mbrojtur, ose motivet politike të gazetarëve të akuzuar, organizatat e respektuara që angazhohen për lirinë e shprehjes kanë treguar vështirësi kur u mësua se të dy dëshmitarët nuk ishin viktima dëshmitarë por kryetari i tanishëm i Kroacisë dhe një ish epror i armatës së Holandës.⁴⁵ “me këtë komprometohet i tërë sistemi i mbrojtjes së dëshmitarëve. Tani,

⁴¹ Intervistë e ICTJ me përfaqësuesit e OJQ-ve, udhëheqës të partive politike, anëtar të gjyqësorit dhe gazetar lokal, 19 – 23 dhjetor 2005

⁴² Një anketë në *Jutarnji List*, një nga gazetatat ditore në Kroaci, i botuar menjëherë pas lajmit për hapjen e bisedimeve për hyrje në BE (tetor 2005), ka treguar rritje të shpejtë të mbështetjes për BE-në, nga 40% në 63.5%. Sipas një raporti të Reutersit, "kjo anketë reflekton[ka reflektuar] besimin se mbështetja e ulët për hyrje në BE ka qenë thjeshtë një reagim ndaj problemeve me Tribunalin e Hagës për krime të luftës dhe ndaj refuzimit të mëhershëm të BE-së". (Reuters, "Mbështetja kroate për BE-në rritet pas fillimit të bisedimeve". 6 tetor 2005). Sipas një ankete tjetër të organizuar nga Standard Barometer, në muajit maj – qershor 2005 dhe të publikuar në fillim të shtatorit 2005, Besimi i qytetarëve kroat në BE është ulur në 28%, kundrejt 42% sa kë qenë në anketën e mëhershme. Anketa ka treguar se qëndrimet e kroatëve në drejtim të BE-së mbesin të paqëndrueshme dh ët ndikuara nga politika ditore, tha delegacioni i BE-së (HINA News Agency, "Besimi i qytetarëve kroat në BE shënon një rënie të konsiderueshme – Anketë ndërkombëtare", 10 shtator 2005).

⁴³ Intervistë me ICTJ, Zagreb, 20 dhjetor 2005.

⁴⁴ *Prokurori kundër Jović, Križić, Šešelj dhe Margetić*, Lënda nr. IT-95-14-R77.4 Aktakuzë e konsoliduar; http://www.un.org/icty/indictment/english/bla-con_3ai051014.pdf

⁴⁵ Shiko Komisioni për të mbrojtur gazetarët, "Komunikatë për shtyp", 7 tetor 2005; <http://www.cpi.org/neës/2005/Croatia07oct05na.html>; Raportuesit pa kufij, "Komunikatë për shtyp", 7 tetor 2005; http://www.rsf.org/article.php3?id_article=15230; "Gjykata e OKB-së kërkon arrestimin e

mua më duhet të mbroj këta gazetarë”, tha një aktivist i njohur i të drejtave të njeriut në Kroaci.⁴⁶

Në datën 10 mars 2006, të dy akuzuarit e parë, Ivica Marijačić dhe Markica Rebić, janë shpallur fajtor dhe secili është dënuar me nga 15,000 euro. Vendimi unanim i Tribunalit konkluduar se shkelja me dashje e urdhrat të gjykatës ka rrezikuar që të nënvlerësohet aftësia e Tribunalit të Hagës të garantojë sigurinë e dëshmitarit, dhe për këtë arsye kjo konsiderohet si përzjerje në administrimin e drejtësisë.⁴⁷ Sidoqoftë, gjatë gjykimit dyditor të dy gazetarëve të akuzuar në janar të vitit 2006, njëri nga gjyqtarët e Tribunalit të Hagës ka shprehur brengë rreth “përdorimit të papërshtatshëm të mjeteve të gjykatës”.⁴⁸ Përderisa gjykimi i katër gazetarëve tjerë është caktuar për muajin korrik, në datën 15 qershor Tribunali ka miratuar kërkesën e Prokurorisë për të tërhequr aktakuzat kundër tre prej tyre, duke cituar “interesat e drejtësisë dhe ekonomisë gjyqësore”.⁴⁹ Çfarëdo qoftë rezultati i rastit të mbetur, sipas të gjitha gjasave kjo episode nuk do të promovojë perceptimin e favorshëm të zhvillimit të procedurës së Tribunalit në Kroaci, meqë gazetarët e akuzuar kanë përdorur këtë për të dalë më shpesh në opinion dhe kanë portretizuar veten si kampione të të drejtave të njeriut. Sidoqoftë, disa komentatorë kanë bërë me dije se çështja e aktakuzave dhe dënimi i Marijačićit dhe Rebićit ka dërguar porosi të forta dëshmitarëve të tanishëm dhe atyre në ardhshëm – qofshin ata zyrtarë të lartë ose dhe qytetarë të rëndomtë – se identitetet e tyre do të ruhen fuqishëm.⁵⁰

iii. Numri i aktakuzave të transferuara nga Tribunali i Hagës

Deri më tani është transferuar vetëm një rast nga Tribunali i Hagës për në Kroaci nën Rregullën 11*bis* të Rregullave të procedurës dhe dëshmive të Tribunalit të Hagës, që mundëson që rastet të transferohen në gjykatat kombëtare pasi t’i jenë nënshtruar disa kushteve.⁵¹ Sipas zyrës së Prokurorit në Tribunal të Hagës dhe Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm në Zagreb, rasti kundër Mirko Noracit dhe Rrahim Ademit⁵² – të akuzuar

gazetarit kroat *The New York Times*, 2 tetor 2005; dhe Përfaqësuesi për Lirinë e medieve i OSBE-së, “Komunikatë për shtyp”, 11 tetor 2005; <http://www.osce.org/item/16565.html>.

⁴⁶ Intervistë me ICTJ, Zagreb, 23 dhjetor 2005.

⁴⁷ *Prokurori kundër Marijačić dhe Rebić*, Lënda nr. IT-95-14-R77.2.; http://www.un.org/icty/blaskic/rebic_contempt/reb-tcj050310e.pdf

⁴⁸ Agjencia SENSE, “Fillon gjykimi sipas aktakuzës për mospërfillje të gjykatës”, 18 janar 2006. Gjyqtari Bonomy, pavarësisht nga shqetësimet që i ka dhënë, nuk është ndarë nga kolegët e tij për të shqiptuar dënimin. Për komente të mëtutjeshme, shiko Misionin e OSBE-së në Kroaci, “Raporti: Tribunali i Hagës dënon dy kroat për mospërfillje të Tribunalit”, 18 mars 2006.

⁴⁹ Rasti kundër Marijačić dhe Rebić është para Dhomës së Apelit. Shiko edhe vendimin e datës 20 qershor 2006 për t’i miratuar Prokurorit kërkesën për tërheqje kundër Šešelj, Margetić dhe Križić, dhe mendimin e ndarë të gjyqtarit Bonomy, <http://www.un.org/icty/Blaškić/trialc1/decisions-e/060620.pdf>.

⁵⁰ Koalicioni për drejtësi ndërkombëtare, “Rastet e Kroacisë për mospërfillje të Tribunalit të Hagës: çështjet dhe analizat”, 18 tetor 2005,

<http://www.cij.org/index.cfm?fuseaction=vieëReport&reportID=703&tribunalID=1>

⁵¹ Rregullat e procedurës dhe dëshmitë, IT/32/Rev. 36, Tribunali ndërkombëtar penal për ish Jugosllavi. Shteti të cilit i transferohen lëndët duhet të ketë juridiksion dhe Tribunali i Hagës duhet të jetë i bindur se në atë vend nuk zbatohet vendimi me vdekje dhe se i akuzuari do të ketë gjykim të drejtë.

⁵² *Prokurori kundër Mirko Norac dhe Rrahim Ademi*, Lënda nr. IT-04-78. Vendimi për transferim tek autoritetet në Republikën e Kroacisë sipas Rregullës 11*bis*, 14 shtator 2005, <http://www.un.org/icty/ademi/trialc/decision-e/050914.htm>. Mirko Norac ka qenë i dënuar në vitin 2003

për krime kundër njerëzimit dhe krime kundër civilëve jokroate në Xhepin e Medakut në vitin 1993 – sipas të gjitha gjasave do të jetë aktakuza e vetme e referuar në Kroaci sipas rregullës 11bis.⁵³ Megjithatë, strategjia për mbylljen e Tribunalit të Hagës mund të ndikojë gjithmonë e më shumë që përpjekjet e Kroacisë për të ndjekur penalisht të dyshuarit përmes transferimit të hetimeve të cilat janë të përfunduara pjesërisht nga Tribunali për në Kroaci.

Prokurori Shtetëror i Kroacisë dhe Prokurori i Tribunalit të Hagës kanë punuar së bashku për të përgatitur transferimin e rasteve tjera ku deri më tani nuk ka pasur aktakuzë (rastet nga kategoria “B” ose “2”). Miratimi i legjislacionit nga parlamenti i Kroacisë në vitin 2003, i cili mundëson përdorimin e dëshmive të mbledhura nga Tribunali i Hagës në gjykatat vendore do të duhej të kontribuojë në zbatimin më të shpejtë të këtij aspekti të strategjisë për mbylljen e Tribunalit të Hagës, si dhe do t’i jep një mbështetje të rëndësishme përpjekjeve vendore në këtë lëmi.⁵⁴ Numri i rasteve dhe individëve të përfshirë nuk është i ditur dhe zyrtarët nuk kanë qenë të gatshëm të japin parashikime të sakta. Sipas burimeve në Tribunal të Hagës, do të duhej të jenë diku rreth 10 deri 25 raste të kategorisë “2” dhe Zyra e Prokurorit do të mund t’i jepte kolegëve të tyre në Kroaci lëndët e gatshme për fillimin e gjyqimit për 40 deri 50 individë.⁵⁵

Pengesë kryesore – sikurse edhe është rasti me referimet e ngjashme në Bosnje dhe Hercegovinë, edhe pse në një shkallë shumë më të madhe – paraqet mosgatishmëria e Tribunalit të Hagës për transferimin e dëshmive dhe informatave të tilla. “Tribunali i Hagës nuk është themeluar për të ndihmuar institucionet tjera”, tha një ish prokuror i Tribunalit të Hagës.⁵⁶ Me afrimin e fundit të mandatit të Tribunalit të Hagës, të tjerët kanë pranuar se kësaj çështje i kushtohet pak rëndësi: “A duhet që kjo të jetë prioritet? Administrata thotë se po na kalon mandati dhe se nuk kemi para për këtë [një lloj transferi]. Absolutisht ka të drejtë, por çfarë do të bëjmë ne me këto raste?” ka pyetur një tjetër anëtar i prokurorisë në Tribunalin e Hagës.⁵⁷ Pasi që Tribunali i Hagës dhe bashkësia ndërkombëtare ka harxhuar aq shumë mjete në hetimin e krimeve të kryera në ish Jugosllavi, ekziston brenga se ata mund të mos shfrytëzojnë përfitimin nga potenciali për investim në sistemet gjyqësore kombëtare përderisa në të njëjtën kohë do të zvogëlonin numrin e rasteve të Tribunalit të Hagës.

B. Gjykimet në gjykatat vendore

Hapësira e aftësisë dhe gatishmërisë së Kroacisë për tu marr, përmes sistemit të vetë të drejtësisë, me krimet e kryera gjatë luftës e ka tërhequr vëmendjen e organizatave

nga gjykata e qarkut në Rjekë për krimet e kryera kundër popullsisë jokroate dhe në kohën e transferimit ka qenë duke kryer burgimin në Kroaci.

⁵³ Intervistat e ICTJ me Prokurorin e Tribunalit të Hagës dhe zyrën e Prokurorit Publik të Kroacisë, Zagreb, 19 – 23 dhjetor 2005.

⁵⁴ Ligji mbi Implementimin e Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale dhe Ndjekja Penale për Veprat kundër Ligjit Humanitar Ndërkombëtar, *Narodne novine* [Gazeta Zyrtare], Nr. 175/2003, 4 nëntor 2003.

⁵⁵ Intervistë e ICTJ-së me punëtorin e prokurorisë së Tribunalit të Hagës, 19 dhjetor 2005.

⁵⁶ Intervistë e ICTJ-së me ish punëtorin e prokurorisë së Tribunalit të Hagës, Sarajevë, 28 tetor 2005.

⁵⁷ Intervistë e ICTJ-së me punëtorin e prokurorisë, Zagreb, 19 dhjetor 2005.

ndërkombëtare dhe vendore të interesuara me çështjen e përgjegjësisë dhe krijimin e sundimit të ligjit. Ky interesim është përforcuar tani që Tribunalin e Hagës është duke arritur fazën e vet përfundimtare, pasi që arsyeshmëria e transferimeve të Tribunalit të Hagës varet nga një vlerësim i të dyjave pajtueshmërinë me ligjin dhe shanset për gjykim të drejt në shtetet marrëse. Vlerësimi i performancës së Kroacisë në ndjekjet penale vendore ka evoluar nga shumë kritikuese gjer në optimizëm të matur. Përmirësime të caktuara janë mirëpritur, që është më e rëndësishmja krijimi i Dhomave Speciale për tu marr me rastet e krimeve të luftës.⁵⁸ Megjithëse Kroacia ka bërë një progres të konsiderueshëm lidhur me këtë gjatë viteve të fundit, një varg çështjesh vazhdojnë të jenë breng për organizatat vendore dhe ndërkombëtare të drejtave të njeriut dhe ato monitoruese. Përveç anshmërisë së vazhdueshme etnike në gjykime, shqetësimi kryesor lidhet me gjykimet në *mungesë*, përfaqësimi ligjor i viktimave, efikasiteti në hetime, dhe bashkëpunimi në mes autoriteteve kombëtare dhe rajonale.

Në tetor 1996, një vit pas përfundimit zyrtar të luftës, Kroacia miratoi *Ligjin mbi Amnestin e Përgjithshme* në mënyrë që të siguroj ri integrimin paqësor të Sllavonisë Lindore. Si rezultat, vetëm ato raste të përjashtuara nga amnistimi do të bien nën juridiksionin e gjykatave vendore. Ky ligj ofron “amnisti nga ndjekja penale dhe gjykimet për kryerësit e veprave kriminale të kryera gjatë agresionit, rebelimin e armatosur ose konfliktet e armatosura në Republikën e Kroacisë” në periudhën nga 17 gushti 1990 gjer me 23 gusht 1996.⁵⁹ Megjithatë, ligji nuk ofron amnisti të plotë, pasi që përjashton “kryerësit e shkeljeve më të mëdha të ligjit humanitar të cilat kanë karakter të krimeve të luftës”,⁶⁰ kryerësit e veprave kriminale të terrorizmit (megjithëse me kaveat që duhet të jetë akt terrorist siç është definuar në ligjin ndërkombëtar) dhe “veprat kriminale të deklaruara në Kodin Penal Themelor të Republikës së Kroacisë (..) të cilat nuk ishin kryer gjatë agresionit, rebelimit të armatosur ose konflikteve të armatosura dhe [të cilat] nuk janë në lidhje me agresionin, rebelimin e armatosur ose konfliktet e armatosura në Republikën e Kroacisë”.⁶¹ Përderisa disa asociacione të viktimave kanë

⁵⁸ Shiko për shembull Misioni i OSBE-së në Kroaci, Raporti i Prapaskenës; Gjykimet Vendore të Krimeve të Luftës 2005”, 13 shtator 2006, http://www.osce.org/documents/mc/2006/09/20668_en.pdf.

⁵⁹ *Narodne Novine* [Gazeta Zyrtare], No. 80/96 të 27 shtatorit 1996 (“Ligji mbi Amnestin e Përgjithshme) Neni 1 Një përkthim jo zyrtar i tekstit të Ligjit mbi Amnestin e Përgjithshme është në dispozicion në <http://www.helpicrc.org/ihl-nat.nsf/0/FB701EC56DF58C9B412565FB005755AC...>.

⁶⁰ Këto përfshijnë aktet vijuese siç janë të radhitura në Kodin Themelor Penal të Republikës së Kroacisë (*Narodne Novine* Nr. 31/93 – versioni i korrigjuar, nr. 35/93, 108/95 dhe 16/96): aktet kriminale dhe gjenocidi (Neni 119), krimet e luftës kundër popullatës civile (Neni 120), krimet e luftës kundër të plagosurve dhe të sëmure (Neni 121), krimet e luftës kundër të burgosurve të luftës (Neni 122), organizimi i grupeve dhe nxitja në gjenocid dhe krime të luftës (Neni 123), vrasjet ilegale dhe plagosja e armikut (Neni 124), konfiskim i paligjshëm i pasurisë nga të vrarit dhe të plagosurit në fushëbetejë (Neni 125), përdorimi i mjeteve të ndaluara në luftim (Neni 126), kundërvajtjet parlamentare (Neni 127), trajtim jo njerëzor i të plagosurve, të sëmure dhe të burgosurve të luftës (128), shtyrje e paarsyeshme e riatdhësimit të burgosurve të luftës (Neni 129), shkatërrimi i monumenteve kulturore dhe historike (Neni 130), Nxitja e luftës agresore (Neni 131), abuzimi i emblemave ndërkombëtare (Neni 132), diskriminimi racia dhe tjetër (Neni 133), krijimi i skllavërisë dhe transportimi i personave të përshirë në skllavëri (Neni 134), terrorizmi ndërkombëtar (Neni 135), rrezikimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare (Neni 136), dhe marrje e pengjeve (Neni 137).

⁶¹ Ligji mbi Amnestin e Përgjithshme, *sipër* shënim 60, Neni 3.

thirur për anulim të amnistimit dhe për diskutime të mëtutjeshme mbi ligjin, si duket nuk ka gatishmëri politike për ta ri parë çështjen nga frika për destabilizimin e paqes.⁶²

Përbrenda Kroacisë, Gjykatat Vendore kanë juridiksion mbi rastet e krimeve të luftës, dhe vendimet e tyre mund të apelojnë në Gjykatën Supreme.⁶³ Në tetor 2003, ishte nxjerr ligji që parashikonte krijimin e Këshillit të Krimeve të Luftës në secilën Gjykatë Vendore ekzistuese.⁶⁴ Ndonëse Ligji i 2003 ishte miratuar kryesisht për të zbatuar Statutin e Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve, ai po ashtu krijoi dhoma tërësisht të specializuara vendore, të përbëra nga tre gjykatës më përvojë në rastet komplekse kriminale.⁶⁵ Ligji po ashtu lejon kalimin e rasteve të caktuara të krimeve të luftës nga Gjykatat Vendore, me juridiksion territorial në Gjykatat Vendore të katër qyteteve më të mëdha në Kroaci (Zagreb, Osijek, Rijekë dhe Split). Kjo është e lejueshme kurdo që Prokurori i Shtetit ka demonstruar që “rrethanat nën të cilat është kryer krimi, dhe urgjenca e gjykimit” e arsyeton atë, dhe që i nënshtrohet pëlqimit të kryetarit të Gjykatës Supreme.⁶⁶ Në korrik 2005, Kryetari i Gjykatës Supreme, lejoi kërkesën e parë të tillë për një rast që të kalon nga Vukovari në Zagreb.⁶⁷ Në mënyrë të ngjashme, rasti kundër Branimir Glavashit (shtjelluar më poshtë) ishte transferuar në Zagreb për të shmangur njëanshmërinë e mundshme nga gjykata me seli në Osijek.⁶⁸

Kjo masë e transferimit ka rezultuar në debat të konsiderueshëm në mes të monitorëve vendor të gjykimeve dhe përbrenda gjyqësorit. Në përgjithësi, si duket ekziston një debat me shtrirje të plotë, nëse jo unanime, përkrahje (nga të dy gjyqësori dhe OJQ-të) për të gjitha rastet e krimeve të luftës të sjellën para katër Gjykatave Vendore kryesore. Kjo përpjekje për të adresuar shqetësimet që katër gjykatat tjera mund të mos jenë në gjendje të mbajnë gjykime të drejta ose ti rezistojnë presionit në rastet më të ndjeshme.⁶⁹ C Rastet tanimë janë zhvendosur prej njëres në gjykatën tjetër në disa raste në të kaluarën.⁷⁰ Në shtesë të forumit të duhur për gjykime, si duket ka përkrahje për zhvendosjen e të gjitha hetimeve të krimeve të luftës në njësit e specializuara përbrenda katër Gjykatave Vendore kryesore dhe, kur është e nevojshme, posaçërisht në Zagreb. Me të vërtet, posaçërisht në lidhje me krimet e kryera kundër serbëve, hetimet policore në Osijek dhe Split nganjëherë janë konsideruar jo efikase ose të penguara qartazi për shkak të presionit lokal nga figurat e fuqishme të cilët mund të jenë ndjerë të kërcënuar. “Policia lokale dhe

⁶² Intervista e ICTJ me OJQ Kroate, korrik 2006.

⁶³ Ka Gjykata Vendore në secilën prej 21 qarqeve të Kroacisë që merren me rastet e krimeve serioze nën Kodin Penal të 1993.

⁶⁴ Ligji mbi Zbatimin e Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare për Krime dhe në Ndjekjen Penale të Veprave Kriminale kundër Ligjit Ndërkombëtar, *Narodne novine* [Gazeta Zyrtare], No. 175/2003, 4 nëntor, 2003 (“Ligji mbi Zbatimin e GjNK”).

⁶⁵ Id., Neni 13 (2).

⁶⁶ Shiko nenin 12 të Ligjit mbi Zbatimin e GjNK, dhe po ashtu, “Drejtësia në Rrezik: Gjykimet e Krimeve të Luftës në Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, dhe Serbi e Mal të Zi”, tetor. 2004, Vol. 16, No. 7 (D), p. 7.

⁶⁷ Rasti kundër Slobodan Davidović, I dyshuar për krime lufte në Bosnje dhe Hercegovinë. Shiko Missioni i OSBE-së në Kroaci, “Raport mbi Ndjekjen Penale të Krimeve Brenda vendit,” 12 gusht 2005, p. 4

⁶⁸ Balkan Insight “Kroacia mund të Liderin e Luftës kundër Vdekjeve Serbe”, 8 korrik, 2006.

⁶⁹ Intervista e ICTJ me anëtarët e OJQ-ve dhe gjyqësinë në Osijek, 20 dhjetor 2005, dhe në Zagreb, 22, 23 dhjetor 2005.

⁷⁰ Për shembull rasti kontrovers i vitit 2001 kundër Norac, Orešković, Grandić and Gredelj (Rasti Kz 985/03-9) ishte transferuar nga Gospić në Rjeka.

gjqësia lokale janë shumë afër popullatës”, tha udhëheqësi i grupit për të drejtat e njeriut në Zagreb⁷¹. Në rrethana të tilla, transferimi i hetimeve në kryeqytet ka dëshmuar mënyrën më të mirë për ti shmangur pengesat.⁷²

Në korrik të vitit 2004, një ndryshim (amendament) i rëndësishëm ishte bërë në Kodin Penal të Kroacisë në mënyrë që të i përfshijnë parimet e përgjegjësisë komanduese për parandalim të dështimit, apo dështim për të dënuar, krimet sipas Ligjit Ndërkombëtar.⁷³ Nëse këto dispozita do të aplikohen në mënyrë retroaktive në të ardhmen në seancat për krimet e luftës të kryera gjatë luftës në vitet 1991-1995 është çështje për diskutim, për në përgjithësi është konsideruar si e pagjasë. Kjo është pjesërisht për faktin se është dukë u zhvilluar një debat nëse aplikimi i ligjit (parimit) të përgjegjësisë për urdhërim do të shkelë ndalimin ligjorë në përgjithësi në aplikim e ligjit retroaktivisht. Por faktorët tjerë mund ta sqarojnë gjithashtu.⁷⁴ Gjykatësi në Zagreb ka pranuar që “ është një ngurrim i përgjithshëm sepse është i ri”, që mund të sugjeron një ambivalentë lidhur me ndryshimin e praktikave të vendosura mënjane nga pyetjet e ligjshmërisë.⁷⁵ Për më tepër, Gjykatësit dhe Prokurorët Kroat mund të jenë ngurrues që të i vazhdojnë rastet që përfshijnë përgjegjësin komanduese me frikën në konfrontimit të shtetit vetvetiu.⁷⁶ Duhet të ceket, megjithëse, në vitin 2002 Gjykata Supreme Kroate ka sugjeruar që akuzat kriminale duke u bazuar në përgjegjësi komanduese mund të dëshmojnë nga “ teoritë vendase të përgjegjësisë kriminale për dështim për të vepruar në ndërthurje me Nenet 86 dhe 87 të Protokollit plotësues 1 të Konventave të Gjenevës të viti 1949”.⁷⁷

⁷¹ Intervista e ICTJ me përfaqësuesit e OJQ-ve, Zagreb 22 dhjetor 2005.

⁷² Shiko shtjellimin e mëposhtëm në rastin Glavash. Megjithatë, sipas një raporti të OSBE-së në prill 2005, 80 përqind e rasteve të mbetura të krimeve të luftës mbesin në gjykatat tjera vendore. Misioni i OSBE-së në Kroaci, Raporti i Prapaskenës; Gjykimet vendore të Krimeve të Luftës 2004”, 26 prill 2005, p.10.

⁷³ Kodi Penal Themelor i Republikës së Kroacisë (*Narodne Novine* (Gazeta popullore) Nr. 31/93 – versioni i korrigjuar , nr. 35/93, 108/95 dhe 16/96), Neni 167a.

⁷⁴ Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë ka miratuar Protokollin e parë plotësues të vitit 1977 të Konventës së Gjenevës me 11 Mars 1977 dhe Protokollin e dytë plotësues me 11 Qershor 1977. Neni 87 i Protokollit të parë plotësues cakton/ vendos detyrat e Komandantëve (urdhëruesve) . përgjegjësia e komandimit është themeluar në nenin 21 të Udhëzimeve në Zbatimin e Rregullave të Ligjeve Ndërkombëtare dhe Zakoneve të Luftës në Forcat e Armatosura të RSFJ, të përvetësuara në vitin 1988. Për analiza krahasuese në lidhje me Serbin, shiko Qendrën Ligjore Humanitare “ Përgjegjësi e komandimit”: “Ligji Bashkëkohorë”. 23 Shkurt 2004, në dispozicion në adresën në vijim http://www.hlc.org.yu/english/Ėar_Crimes_Trials_Before_National_Courts/Serbia/index.php?file=729.

Kroacia ka përmendur qëllimin e saj që të lidhet/mbështetet me Protokollin e parë plotësues për arsye të dokumenteve ligjore të saj të radhitura të depozituara (ruajtura) më 14 Korrik 1993.

⁷⁵ ICTJ intervista me Gjykatësin Kroat, Zagreb në 22 Dhjetor 2005. Shiko gjithashtu Amnesty International “ Brenga e AI’s në zbatimin e “ kompletimit/ përmbushjen e strategjisë) të Tribunalit (Gjykatës) Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë, 6 qershor 2005, , AI Indeksi: EUR 05/001/2005.

⁷⁶ Në Serbin fqinje kjo është cituar si një problem i vazhdueshëm: “ Nuk është e sigurt që profesioni ligjor është emancipuar vetvetiu nga udhëheqësit politik” vendimi në përgjegjësit komanduese. Nuk ka pasur guxim që ta formuloj pozicionin e tij”. Intervista e ICTJ me një Gjykatës në Beograd 25 Nëntor 2005.

⁷⁷ Misioni i OSBE-së në Kroaci “ Raporti: Seancat e Krimeve të luftës në Kroaci dhe përfundimet nga Monitorimi i Gjykimeve” 22 Qershor 2006 . Shiko gjithashtu RH. *RH v. Milan Strunjaš* [Gjykata vendore e Karlovcit]. Gjykata Supreme I-Kz 588/02-9 17 Tetor 2002.

Organizata monitoruese ende e konsiderojnë të jetë i pakënaqshëm numri dhe lloji i krimeve të luftës që janë gjykuar nga Gjykatat Kroate.⁷⁸ Në pajtim me udhëzimet e Zyrës së Prokurorit të Shtetit Kroat, të gjitha hetimet janë shqyrtuar në vitin 2004, duke çuar në ndërprerjen e seancave të rasteve gjyqësore ndaj 485 personave. Nga viti 2005, shënimet kanë treguar që 603 persona janë dënuar për krime lufte –edhe pse shumica prej tyre kanë qenë dënime në mungesë ndërsa 245 persona janë liruar.⁷⁹ Në Dhjetor të viti 2005, Zyra Prokurorit Shtetëror ka thënë që ka pasur rreth 1200 të dyshuar , gjysma prej të cilëve kanë qenë nën hetime dhe gjysma tjetër kanë vazhduar në fazën e padisë. Zyra Prokurorit Shtetëror ka përmendur që nuk pret që numri i hetimeve të rritet.

i. Ballafaqimi me krimet kundër Serbëve

Një zhvillim tjetër i konsiderueshëm në gjykimet në Kroaci ka të bëjë me përpjekjet për të adresuar perceptimin e njëanshmërisë etnike në gjykata. Në vitin 2005, seancat gjyqësore ishin udhëhequr në lidhje me gjashtëmbëdhjetë raste të krimeve të luftës, gjenocidit, ose vrasjeve të paligjshme dhe plagosje të armikut.⁸⁰ Shumica e këtyre seancave ishin sjellë si rezultat i vendimeve të Gjykatës Supreme në të cilat rigjykimi i rasteve të mëparshme ishte urdhëruar. Gjykata Supreme ka treguar gatishmëri që ti anuloi shfajësimin e mëparshëm të anëtarëve të ushtrisë Kroate dhe të forcave policore të akuzuara për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Kjo ishte e dobishme si hapë i parë në ri adresimin e njëanshmërisë në gjykata.

Hetimet e krimeve të luftës dhe ndjekja penale në Kroaci gjer tani janë kritikuar që të jenë në mënyrë të vazhdueshme “Etnikisht të njëanshme”.⁸¹ Në vitin 2004, organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut kanë vërejtur që: prokurorët kanë iniciuar raste kundër Kroatëve dhe kundër Serbëve në proporcion prej 1 në 5; zakonisht Kroatët akuzoheshin për vepra të vogla;⁸² dhe avokatët mbrojtës lejoheshin të shfaqnin pozicion

⁷⁸ ²¹Në fjalët e Human Rights Watch (Vrojtimi i të Drejtave të Njeriut), Mungesë në vitin 2005 për vitin e dytë me radhë, të ndonjë padie ndaj të akuzuarve Kroat ngrit brenga serioze lidhur me sinqeritetin e përpjekjeve mbi përgjegjësin të Qeverisë Kroate” . Human Rights Watch, “ Raporti Botëror i vitit 2005”, Janar 2005, pp. 347-351. Rënia në numër e seancave në këto raste është shënuar gjithashtu nga OSBE-ja në vitin 2005 . Misioni i OSBE-se në Kroaci “ Raporti i gjendjes No.17 i progresit Kroat në Pëmbushjen e Angazhimeve Ndërkombëtare që nga Korriku i viti 2005 “, 10 Nëntor 2005 p. 15 dhe Misioni i OSBE-së në Kroaci, “ raporti i prapaskenës lidhur me Ndjekjen penale te Krimeve vendore te Luftës, Bartja. Transferimi i ICTY Ndjekjet Penale dhe Personat e Zhdukur” 12 Gusht 2005 p. 2.

⁷⁹ Kruhonja, K. (Ed.), “Monitorimi i Gjykimeve Vendore të Krimeve të Luftës. Raporti Vjetor 2005”, Osijek, Qendra për Paqe, Jo Dhunë dhe të Drejta të Njeriut, 2005.

⁸⁰ Id.

⁸¹ EU, “Gjetjet kyçe të vitit 2005 Raportet e Zhvillimit në Kroaci”, 9 Nënt., 2005. Sipas Human Rights Watch, në 2004 “Gjykatat Kroate kanë gjykuar vetëm dy raste që përfshijnë krimet e luftës të kryera kundër Serbëve etnik”. Human Rights Watch, “Raporti Botëror 2005”, Jan. 2005, pp. 364-368. në mënyrë të ngjashme, OSBE ka nxjerr në pah që në vitin 2002, 83 përqind e Serbëve ishin shpallur fajtor në gjykimet për krime lufte dhe vetëm 18 përqind e Kroatëve ishin dënuar. Misioni i OSBE-së në Kroaci, “Raporti i Prapaskenës: Gjykimet Vendore të Krimeve të Luftës në 2002”, Mars. 1, 2004, p. 3. Sipas OSBE-së, nga pesë akuzat e reja për krime lufte që ishin lëshuar në vitin 2005, të gjitha përfshinin akuzimin e Serbëve: Misioni i OSBE-së në Kroaci, “Raporti i Prapaskenës: Gjykimet Vendore të Krimeve të Luftës në 2005”, 13 shtator 2006, p 39.

⁸² Human Rights Watch, “Drejtësia në Rrezik: Gjykimet e Krimeve të Luftës në Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovin, dhe Serbi e Mal të Zi”, Tetor 2004, Vol. 16, No. 7 (D), pp. 12 dhe 13.

kërcënues ndaj dëshmitarëve në rastet kundër Kroatëve.⁸³ Gjersa ky proporcion nuk tregon dhe vetvetiu nuk dëshmon njëanshmërinë etnike, së paku mund të vërehet që numri i përgjithshëm i Kroatëve të dyshuar për kryerjen e krimeve kundër Serbëve nuk është në proporcion me numrin e përgjithshëm të Kroatëve të hetuar dhe të ndjekur penalisht. Në veçanti është përmendur një rast në mënyrë që të ilustron njëanshmëria e pretenduar etnike. Në rastin *Savić*, në vitin 2004, Gjykata e Vendit e Vukovarit e ka dënuar një grua 78 vjeçare serbe të Kroacisë me katër vjet e gjysmë burgim me akuza për krime lufte. Ajo ishte akuzuar që kishte “kallëzuar” tre Kroat të cilët mandej ishin transferuar nga Vukovari në kampin e të arrestuarve në Serbi dhe ishin nënshtruar trajtimit jo njerëzor; dhe që vet ajo kishte kërcënuar dhe nënshtruar keqtrajtimit të një gruaje Kroate të cilën ajo supozohet se e ka shtyrë të gatuj për atë. Ky vendim ishte kritikuar së tepërmi: dëshmia që përkrahte atë supozohet se ishte e pamjaftueshme, dënimi ishte konsideruar si posaçërisht i ashpër në lidhje me krimin e supozuar; dhe po ashtu për shkak se nuk ekzistojnë shënime të rasteve të krimeve të luftës kundër Kroatëve të bazuara në pretendimet për ashpërsi të njëjtë.⁸⁴

Prej 2001, një ndryshim gradual është shfaqur kur Zyra e Prokurorit Shtetëror filloj të akuzoj anëtarët e ushtrisë kroate dhe të forcave policore.⁸⁵ Rasti i *Paulin Dvor* dhe rasti *Gospic* ishin ilustrime të këtij trendi të ri. Në prill 2004, rasti *Paulin Dvor*, Nikola Ivanković, ish anëtar i ushtrisë kroate, ishte dënuar nga Gjykata Vendore e Osijekut me 12 vjet burg për vrasjet e dhjetorit 1991 të 19 serbëve të Kroacisë dhe civileve Hungarez në Paulin Dvor.⁸⁶ Në mars 2003, rasti *Gospic*, Gjenerali i ushtrisë kroate Mirko Norac, Stjepan Orešković dhe Stjepan Grandić ishin shpallur fajtor për krime lufte dhe ishin dënuar nga Gjykata Vendore e Rjekës me 12, 15 dhe 10 vite burgim, gjegjësisht, për vrasjen e 50 civilëve, të cilët kryesisht ishin Serb, në vitin 1991 në Gospic.⁸⁷

Dy raste të tjera të rëndësishme lidhur me këtë janë rasti i *Korana Ures*⁸⁸ dhe rasti *Lora*.⁸⁹ Në rastin e *Korana Ures*, Gjykata Supreme kishte urdhëruar rigjykimin e tretë që nga

⁸³ Kruhonja, K. (Ed.), “Monitorimi i Gjykimeve për Krime të Luftës. Raporti Vjetor 2005”, Osijek, Qendra për Paqe, Pa dhunë dhe për të Drejta të Njeriut, 2005, p. 29.

⁸⁴ Shiko Human Rights Watch, “Drejhtësia në Rrezik: Gjykimet e Krimeve të Luftës në Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovin, dhe Serbi e Mal të Zi”, tetor. 2004, Vol. 16, No. 7 (D), p. 9 dhe Human Rights Watch, “Rasti i Ivanka Savić, Dokumenti Udhëzues”, korrik 19, 2004. OSBE po ashtu ka vërejtur se në ndjekjen e krimeve të luftës “ende ka disa pabarazi në baza të origjinës kombëtare. Më e theksuara është dallimi në llojin e kryerjeve për të cilat Serbët dhe Kroatët janë akuzuar, për atë që Serbët ishin akuzuar për një gamë të gjerë të kryerjeve gjersa Kroatët janë pothuajse të akuzuar vetëm për vrasje”. Misioni i OSBE-së në Kroaci, “Raporti i Prapaskenës mbi Ndjekjen Penale Vendore të Krimeve të Luftës, Transferimi i Gjykimeve të Tribunalit të Hagës dhe Personat e Zhdukur”, 12 gusht 2005, p.3.

⁸⁵ Kruhonja, K. (Ed.), “Monitorimi i Gjykimeve të Krimeve të Luftës. Raporti Vjetor 2005”, Osijek, Qendra për Paqe, Pa dhunë dhe për të Drejta të Njeriut, 2005, p. 16.

⁸⁶ Vendimi i gjykatës Vendore të Osijekut 18/03, 8 prill 2004. duhet të theksohet ndonëse disa të cilët kanë ndjekur gjykimin kanë kritikuar rënd faktin që gjykata nuk ka dashur të hetoj se kush ka dhen urdhrat për vrasje dhe për largimin e trupave. Ata po ashtu kanë përshkruar presionin kërcënues në dëshmitarët. Shiko Kalimet Online, “Imuniteti Mbizotëron”, 8 dhjetor 2005.

⁸⁷ “Ish Gjenerali, i Dënuar në Gjykimet e Krimeve të Luftës në Kroaci”, *Southeast European Times*, Mars. 25, 2003, në dispozicion në http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2003/03/030325-SVETLA-001. Shiko diskutimin e mësipërm në faqe 5.

⁸⁸ Akuza nga Zyra e Prokurorit Vendor nga Karlovac, No. KT-48/91.

viti 1992. Rasti kishte të bënte me Mihajlo Hrastov, anëtar i forcave policore kroate i akuzuar për vrasjen e më shumë se një duzine të burgosurve serb. Në rastin *Lora*, anëtar të policisë ushtarake kroate ishin akuzuar për torturim dhe vrasje të civilëve serb në burgun ushtarak të Loras në Split në vitin 1992. Pas shfajësimit e të gjithë të akuzuarve në gusht 2004, Gjykata Supreme urdhëroi rigjykimin, i cili filloj para Gjykatës Vendore të Split në shtator 2005.⁹⁰ Me 2 mars 2006, të gjithë tetë të akuzuarit - përfshirë katër në *mungesë* – ishin shpallur fajtor dhe dënuar prej gjashtë gjer në tetë vjet burgim.⁹¹

Organizatave të drejtave të njeriut dhe liderët e minoritetit serb në Kroaci kanë mirëpritur përkrahjen e rritur të qeverisë kroate për ndjekjen penale vendore të krimeve të luftës të kryera nga anëtarët e shumicës kroate.⁹² “Ka zhvillime të ngadalshme por të dukshme. Sot, 1000 serb i janë nënshtruar hetimeve. Dy vite më parë ishin 4000. Prej këtyre 1000 njerëzve, 500 gjer në 600 janë në dosjet e policisë, pa mbikëqyrje të gjyqësorit. Kjo është ajo në të cilën ne jemi duke punuar tani: pastrimi i dosjeve të policisë. Prokurori i Shtetit është pajtuar të punoj në këtë”, deklaroi lideri i partisë politike të serbëve të Kroacisë.⁹³ Në mesin e aktivistëve të drejtave të njeriut dhe gazetarëve të intervistuar nga ICTJ, ekziston një ndjenjë e përbashkët që pranimit publik dhe debati lidhur me krimet e kryera kundër serbëve të Kroacisë është ngritur gjatë disa viteve të kaluara. OSBE e ka nënvizuar brengën e saj që “pjesëmarrja në Luftën për Atdhe” vazhdon të përdoret nga gjykatat e Kroacisë si faktor lehtësues në zvogëlimin e dënimeve kundër kroatëve të akuzuar⁹⁴. Kjo mund të shpjegoj deklaratën e redaktorit të famshëm kroat: “ Prandaj sot mund të thuhet që më nuk është sekret për askënd që kroatët po ashtu kanë kryer krime të luftës, por është bërë aq pak për ti dënuar ata”.⁹⁵

Megjithatë, në dhjetor 2005, dy incidente demonstronin që ende ka presion nga ata që janë përgjegjës për krimet kroate. Së pari, me 6 dhjetor, gazetari udhëheqës hulumtues i gazetës së pavarur, *Feral Tribune*, Drago Hedl, ka marr kërcënime me vdekje në e-mail – që kanë qenë të drejtuara ndaj atij si dëshmitar i cituar në njërin prej artikujve të tij. Që nga fundi i 1990, Hedl ka botuar tregime të pakrahasueshme për krimet e kryera nga ushtria kroate kundër serbëve të Kroacisë. Në raportin e publikuar në korrik të vitit 2005, ai botoi deklaratat e dëshmitarit lidhur me përfshirjen e mundshme të Branimir Gllavashit, udhëheqës i fuqishëm politik, ish komandant i forcave mbrojtëse në Osijek, dhe kryetar aktual i Këshillit Komunal dhe anëtar i opozitës në Parlament.⁹⁶ Në natën e

⁸⁹ Akuza nga Zyra e Prokurorit Vendor në Split, No. KTO 131/02 të 25 marsit, 2002.

⁹⁰ Shiko Southeast European Times, “Gjykimi i Krimeve të Luftës së Tetë ish Policëve Ushtarak Ri hapet në Kroaci”, 13 shtator 2005, në dispozicion në www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2005/09/13/feature-01.

⁹¹ Shiko Qendrën Ligjore Humanitare, “Ri Gjykimi i Suksesshëm i Rastit Lora”, 3 mars 2006, në dispozicion në http://www.hlc.org.yu/english/Facing_The_Past/index.php?file=1312.html

⁹² Human Rights Watch, “Drejtësia në Rrezik: Gjykimet e Krimeve të Luftës në Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovin, dhe Serbi e Mal të Zi”, tetor. 2004, Vol. 16, No. 7 (D), p. 5.

⁹³ ICTJ intervista me politikanin Serb të Kroacisë, Zagreb, 19 dhjetor, 2005.

⁹⁴ Misioni i OSBE-së në Kroaci, “Raporti i Prapaskenës: Gjykimet Vendore të Krimeve të Luftës në 2005”, 13 shtator 2005, p.28.

⁹⁵ Kalimi Online, “Imuniteti Mbizotëron”, 8 dhjetor, 2005.

⁹⁶ Kërcënimet me vdekje të raportuara e than që “ne do të vramë që të dy juve dhe dëshmitarin”. Agjencia e lajmeve France Press, “Kërcënimi me Vdekje Ndaj Gazetarit Kroat që Raporton mbi Luftën”, 7 dhjetor, 2005. me 11 maj, një ditë pasi Parlamenti hoqi imunitetin për Glavashin, Hedl ishte abuzuar verbalisht,

18 dhjetorit 2006, kryetari i Komitetit Civil për të Drejtat e Njeriut, një organizatë me seli në Zagreb, ishte sulmuar përball shtëpisë së tij. “Ne e dimë se kush je ti, ne jemi veteranët nga Vukovari, ne e dimë se si të merremi me ty dhe çfarë të bëjmë me ty”, u raportua të i kenë thënë sulmuesit.⁹⁷

Në këtë kontekst, sfida më e madhe për drejtësinë kroate në lidhje me krimet kundër Serbëve është pa dyshim hetimi i supozimeve që vazhdojnë kundër Branimir Gllavashit. Glavash, anëtar themelues i Bashkimit Demokratik Kroat konsiderohet si njëri ndër politikanët më të fuqishëm në vend gjatë 15 viteve të kaluara. Në qershor 2005, hetimet në rastin kundër tij ishin hequr nga policia e Osijekut dhe ishin vendosur nën kompetencë të policisë së Zagrebit. Në fund të vitit 2005, gjersa hetimet kundër Gllavashit ishin than se po përparojnë shpejt, dy incidente ngritën shqetësime serioze për shoqërinë civile. Së pari, kryebashkiaku i Osijekut, një aleat i ngushtë politik i Gllavashit, zbuloi emrat e 19 dëshmitarëve të akuzës gjatë një konference për shtyp.⁹⁸ Konferenca mandej ishte transmetuar nga Televizioni i Osijekut katër herë në dy ditë. Ishte thënë se katër dëshmitar kishin thirrur policin për të thënë se më nuk janë të gatshëm të dëshmojnë. Ky incident ka qar Komitetin Kroat të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të shpall se situata që e rrethon hetimin ishte e barazvlefshme me “atmosferën linçuese”.⁹⁹ Së dyti, ashtu siç është përmendur më herët, më pak se një javë pas konferencës, gazetari udhëheqës hulumtues Drago Hedl kishte pranuar kërcënime me vdekje që thuhej se ishin drejtpërdrejt të lidhura me raportimin e tij lidhur me hetimet e Gllavashit. Parlamenti i Kroacisë hoqi imunitetin e Gllavashit më kërkesë të Zyrës së Prokurorit Shtetëror, e cila ishte përkrahur nga Gjykata e Apelimit.¹⁰⁰ Që nga atëherë rasti i është dhënë një gjykatësi hetues i cili ka hapur një hetim zyrtar të krimeve të luftës kundër Gllavashit me kërkesë të prokurorëve të shtetit të cilët supozojnë që ai ka urdhëruar vrasjen e dy serbëve dhe torturimin e tre të tjerëve.¹⁰¹ Pas refuzimit fillestar të mocionit të gjykatësit për arrestimin paragjyqësor të Gllavashit, Komisioni për Privilegje dhe Kredenciale në fund dha mocionin me 26 tetor 2006, pjesërisht prej brengës që Gllavash mund të ndikonte tek dëshmitarët.¹⁰² Gllavash u dorëzua në të njëjtën ditë, pasi që policia lëshoi një urdhër për arrestimin e tij.¹⁰³ Pas grevës së urisë 37 ditësh si protestë për atë që ai pretendon se është rast politikisht i motivuar, që nga janari 2007, gjykatësi hetues vendosi që përkohësisht të

përfshirë kërcënimin me vdekje, në rrugët e Osijekut, Shiko HINA Agjencia Kroate e Lajmeve, HND Kritikon Kërcënimet me Vdekje Gazetarit të Osijekut., 10 maj, 2006.

⁹⁷ Zoran Pusić, i cili ishte sulmuar, po ashtu tha se ai nuk mendonte se sulmi ishte i organizuar. Intervista e ICTJ-së me Zoran Pusić, Zagreb, 18 dhjetor, 2005..

⁹⁸ Anto Đapic, krye bashkiak i Osijekut, është po ashtu kryetar i Partisë Kroate të Djathtëve.

⁹⁹ HINA Agjencia e Lajmeve, “Human Rights Watchdog Urges Croatia to Stop Violence Against Journalists”, 8 dhjetor 2005.

¹⁰⁰ HINA Agjencia e Lajmeve, “Gjykata Kroate e jap lejen për hetimin për krime të luftës kundër zyrtarëve të lart”, 5 korrik, 2006.

¹⁰¹ VOA Lajmet, “Gjykatat Kroate fillojnë Hetimin për Krime Luftë të Deputetit”, 13 korrik, 2006.

¹⁰² IWPR, “Glavashi më në fund pas grilave”, 27 Tetor, 2006, në dispozicion në http://iwpr.net/?p=tri&s=f&o=324905&apc_state=henptri.

¹⁰³ Id.

suspendoj hetimin dhe të liroj Gllavashin, në baza se ai nuk ishte i shëndetshëm ti qëndroj gjykimit, edhe pse prokurorët kishin apeluar vendimin¹⁰⁴

Mënjë nga rigjykimet e përmendura më lart, nuk kishte padi të reja kundër anëtarëve të ushtrisë kroate ose të forcave të policisë me akuza për krime lufte në vitin 2005.¹⁰⁵ Megjithatë, shumë raste të mëparshme kundër ish anëtarëve të ushtrisë dhe të forcave të policisë kanë pas prirje të ngarkohen për krime konvencionale se sa për krime të luftës, edhe pse ato mund të jenë të lidhura ngushtë me luftën.¹⁰⁶

ii. Mbrojtja e dëshmitarit dhe përfaqësimi ligjor i viktimave

Mbrojtja e dëshmitarëve është çështje periodike e shqetësimit në gjykimet për krime lufte në Kroaci. Së fundi ka pasur zhvillime të rëndësishme legjislative dhe institucionale në këtë lëmi; miratimi i *Ligjit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve*¹⁰⁷ në tetor 2003, krijimi i programit për mbrojtjen e dëshmitarëve në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si dhe krijimi i njësisë për përkrahje të veçantë të dëshmitarëve përbrenda Ministrisë së Drejtësisë në vitin 2005. Frika është shprehur nga dëshmitarët në rastet kundër anëtarëve të ushtrisë kroate dhe forcave policore, posaçërisht në rastet që kanë marr vëmendjen e madhe publike siç janë gjykimet *Norac*, *Lora*, dhe *Paulin Dvor*. Akte serioze të frikësimit dhe kërcënime verbale gjatë këtyre gjykimeve¹⁰⁸ dhe në hetimin e rastit Gllavash¹⁰⁹ janë dëshmi të lidhjes dhe zhvillimit të legjislativit dhe të institucioneve.

¹⁰⁴ BBC Lajmet, “Deputeti i Burgosur Kroat në Grevë Urie”, 27 tetor, 2006; HINA Agjencia e Lajmeve “Prokurorët Apelojnë Vendimin për Suspendimin e Hetimeve kundër Glavashit në Rastin Garazha”, 4 janar 2007.

¹⁰⁵ Misioni i OSBE-së në Kroaci, “Raporti Statusor No.17 mbi Progresin Kroat në Përmbyshjen e Angazhimeve Ndërkombëtare që nga korriku 2005”, 10 nëntor, 2005, p.16.

¹⁰⁶ Kruhonja, K. (Ed.), “Monitorimi i Gjykimeve për Krime Lufte. Raporti Vjetor 2005”, Osijek, Qendra për Paqe, Pa dhunë dhe për të Drejta të Njeriut, 2005, p. 16.

¹⁰⁷ Ligji mbi Mbrojtjen e Dëshmitarit, *Narodne novine* [Gazeta Zyrtare], No. 163/2003, 16 tetor, 2003.

¹⁰⁸ Në vitin 2002, gjykimi i parë në rastin Lora, i cili ishte anuluar nga Gjykata Supreme në vitin 2005, disa dëshmitar deklaruan në gjykatë se ata i ishin nënshtruar kërcënimeve dhe disa të tjerë refuzuan që të vijnë nga Serbia ose Bosnjë Hercegovina për të dëshmuar në gjykim. (në ri gjykim që u mbajt në fund të vitit 2005, dhe në fillim të vitit 2006, dhjetë dëshmitar erdhën nga Serbia dhe BeH.) Shiko Human Rights Watch, Human Rights Watch, “Drejtësia në Rrezik: Gjykimet e Krimeve të Luftës në Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, dhe Serbi e Mal të Zi”, tetor. 2004, Vol. 16, No. 7 (D), p. 23. Shiko po ashtu Kruhonja, K. (Ed.), “Monitorimi i Gjykimeve për Krime Lufte. Raporti Vjetor 2005”, Osijek, Qendra për Paqe, Pa dhunë dhe për të Drejta të Njeriut, 2005. po ashtu është me rëndësi të përmendet që Milan Levar, dëshmitar i mundshëm në rastin Gospić, ishte vrarë në vitin 2000 pasi që i dha deklaratë Zyrës së Prokurorit të Tribunalit të Hagës (Tribunali Ndërkombëtar për Krime ne Jugosllavi) dhe pasi që publikisht kallëzoi të akuzuarit në atë rast në Kroaci. Shiko Raportimin e Institutit për Luftë dhe Paqe, “Dëshmitari i mundshëm vdesë në Kroaci – Mjeti Eksploziv vret Milan Levar jashtë shtëpisë së tij”, Azhurnimi i Tribunalit 188 (28 gusht – 2 shtator 2000) në dispozicion në www.ihpr.net/?p=tri&s=f&o=164533&apc_state=hsritri2000.

¹⁰⁹ Pasi që krye bashkiaku i Osijekut publikisht i dha emrat e dëshmitarëve në hetimin e Glavashit, Tribunali i Hagës në Kroaci. Shiko HINA Agjencia e Lajmeve, Tribunali i Hagës i alarmuar nga dështimi i Kroacisë për të mbrojtur dëshmitarët”, 17 dhjetor, 2005. Së fundi, Glavash publikoj emrat e dëshmitarëve të mbrojtur në faqen e vet të internetit: Associated Press, “Gjykatësi refuzon thirrjet për të burgosur anëtarin e ish partisë në pushtet në Kroaci i akuzuar për vepra mizore gjatë kohës së luftës”, 21 korrik, 2006.

Prandaj, sfida më e madhe me të cilën ballafaqohet autoritetet kroate është zbatimi i këtyre masave të reja.

Përkundër krijimit të mekanizmave për mbrojtjen e dëshmitarit në vitin 2005, ka qenë e vështirë që të sigurohet që vet dëshmitarët ti përmbahen masave mbrojtëse¹¹⁰, posaçërisht duke marr parasysh madhësinë e vogël të vendit, që e bën më të lehtë zbulimin e dëshmitarëve të zhvendosur. Çështja është më e spikatur në qytete të mëdha siç është Zagrebi, por ishte theksuar që niveli i frikës dhe frikësimit në mënyrë të veçantë është ende e theksuar në fshatra.

Gjykimi Ovčara në Serbi po ashtu ka dhënë argumente të reja për ata që avokojnë se viktimat duhet të jenë pjesë e gjykimit si paditës civil se sa vetëm dëshmitar.¹¹¹ Ligji kroat thotë që viktimat mund të kenë përfaqësimin e vet ligjor në gjykime. Megjithatë, në praktik, ata nuk kanë pasur një përfaqësim të tillë. Për më tepër, për dallim nga Serbia, ku *palët civile* mund të përfaqësohen nga jo avokatët, përfaqësimi në Kroaci duhet të jetë nga një avokat i thirrur nga Oda e Avokatëve dhe shpesh është shumë shtrenjtë për viktimat që t`ia mundësojnë vetes.¹¹² Sipas monitoruesit të lartë të gjykimeve në Kroaci, në 13 gjykimet për krime lufte të monitoruara, vetëm dy prej 235 viktimave të implikuar kanë pasur përfaqësim ligjor.¹¹³ Argumentet që përkrahin përfaqësimin ligjor të viktimave në gjykime përfshin qasje më të mirë të interesave të tyre specifike, si dhe njohje më të mirë të lëndimit që ata kanë vuajtur. Argumentet që e kundërshtojnë atë, janë rreziku i vonimeve të mëtutjeshme të gjykimit, konflikti i mundshëm me prokurorin e përgjithshëm, dhe nevojën që përfaqësimi i viktimës të jetë i kufizuar në seancën e vendimit.

Draft ligji aktual mbi ndihmën ligjore ofron pa pagesë ndihmë ligjore për secilin me të hyra mujore më të vogla se 1,800 kuna (afër 250 euro). Megjithatë, është e paqartë se sa njerëz mund të kualifikohen për këtë. Disa të tjerë ende mendojnë që sistemi i drejtësisë, dhe me të vërtet shoqëria si e tërë, ende nuk është “pjekur” mjaft për të përfshirë viktimat në procesin gjyqësor. Ata theksojnë që, në kontekstin e ndjeshëm të Kroacisë,

¹¹⁰ Në rastin e vetëm të dokumentuar të dëshmitarit i cili ishte pranuar në programin special të mbrojtjes së dëshmitarit dhe ishte zhvendosur nga qyteti i vet i lindjes, dëshmitari i zhvendosur në mënyrë të përsëritshme ka kontaktuar mediat nga vendndodhja e tij e re. Intervistat e ICTJ-së me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm dhe me organizatat lokale të drejtave të njeriut, Zagreb, 22 dhe 23 dhjetor, 2005.

¹¹¹ Në këtë etapë të rastit para Dhomës për Krime Lufte të Gjykatës së Qarkut në Beograd, 14 Serb ishin dënuar 2005 për krime kundër të burgosurve të luftës. Të paditurit ishin akuzuar për keqtrajtim dhe vrasje të 192 individëve në fermën e Ovqares afër Vukovarit në vitin 1991. ata ishin dënuar me burgim prej 5 gjer në 20 vjet. Dy të akuzuar të tjerë ishin shfajësuar. Padia KV No. 01-2003. Gjykimi filloj në mars 2004 dhe ishte gjykimi i parë për krime lufte i mbajtur para Gjykatës së Veçantë në Serbi. Shiko Southeast European Times, “Gjykimi i Parë për Krime Lufte të Hapet në Mars”, 20 jan 2004, në dispozicion në http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2004/01/040120-SVETLA-001.

¹¹² Një avokat zakonisht do të kërkoj 2000 kuna (afërsisht 270 euro) për paraqitje një ditore në gjykatë. Sipas avokatit Kroat që mbron Serbët e Kroacisë në padit civile, avokatët në Kroaci janë të lidhur nga kodi i tyre i etikes dhe nuk mund të punojnë *pro bono* (vullnetarisht) ose të zbatojnë çmime më të ulëta. Për më tepër, nëse një avokat është punonjës me pagë i një ndërmarrje ose OJQ, ai ose ajo nuk mund më të paraqitet si avokat gjyqësor në rastet kriminale. Intervista e ICTJ me avokatin Kroat që mbron Serbet e Kroacisë në paditë civile, Zagreb, 22 dhjetor 2005.

¹¹³ Intervista e ICTJ me Qendrën për Paqe, Zagreb, 22 dhjetor 2005.

aktgjykimet e paanshme do të jenë më të vështira të arrihen me pjesëmarrje të plotë dhe të drejtpërdrejt të viktimave. Një aktivist i dalluar i të drejtave të njeriut e ka përmbledhur situatën:

Në afat të gjatë, drejtësia nuk ekziston nëse viktimat nuk janë të përfaqësuara. Ne jemi si në sandviç, [ne jemi] në mes të një drejtësie që mund të kemi sot dhe një që mund të kemi në mënyrë ideale. Nuk është çështje e parimit por e të qenit realist. Sot, është e arsyeshme për drejtësinë në Kroaci që viktimat nuk janë të përfaqësuara. Situata në Serbi është ndryshe. Atje nuk kishte luftë dhe njerëzit nuk e kanë përvojën e njëjtë të luftës.¹¹⁴

Megjithatë, Qendra për të Drejtën Humanitare e sheh rolin e vet në përfaqësimin e viktimave gjatë gjyqimeve në Serbi si atë të mbrojtësit të drejtave të njeriut, që mund të vë në dukje më shumë përgjegjësinë e të akuzuarit – dhe lidhjet me institucionet shtetërore siç janë policia dhe ushtria – se që mund të bëjë prokurori i përgjithshëm, kështu duke përgatitur dokumente shtesë të krimeve.¹¹⁵

iii. Bashkëpunimi në mes të autoriteteve dhe efikasiteti hetues

Bashkëpunimi në mes të autoriteteve është thelbësor nëse hetimet do të bëheshin si duhet, në të dy nivelet, në atë kombëtar dhe atë rajonal. Bashkëpunimi gjyqësor ndërshtetëror së fundi ka treguar shenja premtuese të zhvillimit, më parë, një bashkëpunim i tillë ka qenë i lidhur me punën e paragjyimit përmes shkëmbimit të informatave dhe dëshmimeve gjatë hetimeve. Por së fundi ka arritur fazën e gjyqimit, me ardhjen e dëshmimeve të dëshmitarëve përtej kufirit. Një përmirësim i tillë, i cili ishte i pamundur të imagjinohej vetëm dy vite më parë, ishte i dukshëm posaçërisht në rastin *Lovas*¹¹⁶ para Gjykatës Vendore të Vukovarit dhe rasti *Ovqara*¹¹⁷ para Dhomës për Krime të Luftës të Gjykatës së Qarkut të Beogradit. Ishte bërë e mundur nga korniza mbi bashkëpunimin e gjyqësorit nënshkruese e të cilës është Kroacia. Kjo kornizë përfshin marrëveshjen në mes të Kroacisë dhe Bosnjë Hercegovinës mbi bashkëpunimin e gjyqësorit në çështjet kriminale të nënshkruar në vitin 1996;¹¹⁸ marrëveshja në mes të Kroacisë dhe Serbisë e Malit të Zi në ndihmën e dyanshme në çështjet civile dhe kriminale të nënshkruar në vitin 1998;¹¹⁹ Konventa

¹¹⁴ Intervista e ICTJ me aktivistin kroat të drejtave të njeriut, Zagreb, 23 dhjetor 2005.

¹¹⁵ Intervista me Nataša Kandić, HLC, korrik 2006.

¹¹⁶ Në tetor të vitit 2005, Prokurori Shtetëror për Krime të Luftës në Serbi deklaroi që do të kryej hetimet mbi personat e kërkuar në rastin *Lovas* që dihet se gjinden në territorin e saj. Shiko Misioni i OSBE-së në Kroaci “Raporti Statusor No.17 mbi Progresin Kroat në Përmeshjen e Angazhimeve Ndërkombëtare që nga korriku 2005” 10 nëntor 2005, p. 17.

¹¹⁷ Në këtë rast, në të cilin të paditurit ishin akuzuar për krime lufte kundër popullatës etnike Kroate në Vukovar në vitin 1991, Prokurori Serb dhe gjykatësi hetues me prokurorin për Krime të Luftës në Zagreb dhe grumbulluan informata të rëndësishme dhe dëshmi për rastin. Shiko Human Rights Watch, “Drejtësia në Rrezik: Gjykimet e Krimeve të Luftës në Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, dhe Serbi e Mal të Zi”, tetor. 2004, Vol. 16, No. 7 (D), p. 19.

¹¹⁸ Marrëveshja në mes të Qeverisë së Bosnjë Hercegovinës dhe Qeverisë së Federatës së Bosnjës dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, mbi Ndihmën Ligjore në Çështjet Civile dhe Kriminale, Gazeta zyrtare e Republikës së BeH (Gazeta Zyrtare e Bosnjë Hercegovinës) – Botimi Special, Marrëveshjet Ndërkombëtare, 27 maj 1996.

¹¹⁹ Marrëveshja në mes të Republikës së Kroacisë dhe Republikës Federale të Jugosllavisë mbi Ndihmën Ligjore në Çështjet Kriminale dhe Civile, *Narodne Novine* (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kroacisë, No. 6/1998, 10 prill 1998.

Evropiane mbi Ekstradimin, dhe Konventa Evropiane në Ndihmën e Dyanshme në Çështjet kriminale pjesë e së cilës është Kroacia.¹²⁰ Së fundi, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm të Kroacisë nënshkroi një marrëveshje me Gjykatën Shtetërore të Bosnjë Hercegovinës për të përmirësuar bashkëpunimin në nivelin e ndjekjeve penale në rastet e krimeve të luftës dhe krimit të organizuar.¹²¹ Një marrëveshje e ngjashme është nënshkruar me Kryeprokurorin Shtetëror të Malit të Zi.¹²²

Përmirësimi i bashkëpunimit të gjyqësorit po ashtu ishte mundësuar nga OJQ-të lokale, veçanërisht Qendra për të Drejtën Humanitare (HLC) e Beogradit. Në gjykimin *Ovqara* që është mbajtur në Beograd, HLC, e cila mori përfaqësimin ligjor të viktimave, të organizuar për afër 20 anëtar të familjeve të viktimave nga zona e Vukovarit për të përcjell seancat gjatë periudhës një vjet e gjysmë. “HLC na ka kontaktuar. Në fillim, familjet nuk donin të shkonin dhe mendonin se ishte farsë. Por besimi në HLC ishte vendimtar. Ne u pajtuam dhe i bindëm dëshmitarët që të shkojnë në Serbi”, tha njëri prej përfaqësuesve të viktimave të Kroacisë.¹²³ Iniciativa ishte lavdëruar si e arritur e madhe për viktimat, si dhe për komunitetet në të dy anët e kufirit. “Është një prej shembujve më të mirë se si duhet të merret me krimet e luftës; tha një përfaqësues i komunitetit serb në Vukovar.¹²⁴ OJQ-ja udhëheqëse monitoruese e gjykimeve theksoi që, pas kësaj përvoje, “asociacioni i viktimave ka ndryshuar plotësisht retoriken e tyre; tani thonë se është në rregull nëse [të akuzuarit] gjykohen në Beograd. Sot, me pak ndihmë, është e mundur të imagjinosh shkuarjen e dëshmitarëve në Serbi dhe anasjelltas. Frika ende ekziston, por mund të kontrollohet”.¹²⁵

Dy dëshmitarë po ashtu dëshmuan përmes video lidhjes nga Kroacia në Gjykimin *Ovqara*, në Bosnjë Hercegovinë, dëshmuan para Gjykatës Vendore në Split në nëntor 2005 dhe janar 2006. Rasti *Lora* ishte shembulli i parë i dëshmitarëve serb që donin të udhëtonin në Kroaci, të inkurajuar nga të dy, Zyra e Prokurorit të Serbisë dhe HLC. Mbrojtja e viktimave ishte siguruar nga të dy policitë e Serbisë dhe Kroacisë.¹²⁶ Gjykimet e ardhshme kundër anëtarëve të “Shkorpionëve”, njësisia speciale e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, do të paraqes edhe një test tjetër të rëndësishëm në bashkëpunimin në rritje në mes të autoriteteve të gjyqësorit nga Kroacia, Serbia dhe Mali i Zi.¹²⁷

¹²⁰ Human Rights Watch, “Drejtesia në Rrezik: Gjykimet e Krimeve të Luftës në Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, dhe Serbi e Mal të Zi”, tetor. 2004, Vol. 16, No. 7 (D), p. 18.

¹²¹ Protokollin mbi Marrëveshjen në Realizimin e Bashkëpunimit të Dyanshëm në Luftimin e të Gjitha Formave të Krimeve Kapitale të nënshkruar në mes të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Kroacisë dhe Prokurorit Shtetëror të Republikës së Bosnjë Hercegovinës. Human Rights Watch, “Kërkimi i Drejtësisë: Dhoma për Krime të Luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë”, shkurt 2006, në dispozicion në <http://hrw.org/reports/2006/ij0206/ij0206ëeb.pdf>.

¹²² HINA Agjencia Kroate e Lajmeve, “Mali i Zi dhe Kroacia të bashkëpunojnë në ndjekjen penale të dyshuarve për krime të luftës”, 27 korrik 2006.

¹²³ Intervista e ICTJ me përfaqësuesin e viktimave Kroate, Zagreb, 23 dhjetor 2005.

¹²⁴ Intervista e ICTJ me përfaqësuesin e viktimave Serbe, Vukovar, 21 dhjetor 2005.

¹²⁵ Intervista e ICTJ me OJQ Kroate, Zagreb, 22 dhjetor, 2005.

¹²⁶ Intervista me Nataša Kandić, korrik 2006.

¹²⁷ Megjithëse Shkorpionët nuk kanë lidhje me Kroacinë, Autoritetet e gjykatës Kroate kanë ndarë dokumentacionin me Dhomën Serbe të Krimeve të Luftës për rastin.

Bashkëpunimi ndër shtetëror është po ashtu fundamental në zvogëlimin e numrit të gjykimeve të mbajtura në mungesë. Gjykata Supreme dhe Prokurori Shtetëror i Kroacisë kanë dhënë udhëzime për të ndarë gjykimet kundër të paditurve të cilëve ju dihet vendndodhja nga ata që janë në ikje. Përkundër kësaj, në vitin 2005, përafërsisht 60 përqind e të paditurve dhe afërsisht 75 përqind e të gjithë të paditurve serb ishin gjykuar në mungesë.¹²⁸ Numri i madh i gjykimeve në mungesë është pjesërisht rezultat i grupit të madh të padive që vazhdojnë në gjykime edhe kur disa nga të akuzuarit janë ende në liri. Baza për këto padi të përbashkëta është shpesh anëtarësia e të akuzuarit në njësi të veçantë të policisë ose ushtrisë dhe, nganjëherë, fakti i thjeshtë që të paditurit e shumëfishitë ishin prezent në vendndodhjen e të njëjtit krim.

II. KËRKIMI I SË VËRTETËS

Mediat e pavarura dhe OJQ-të kanë luajtur një rol të rëndësishëm në iniciativat e kërkimit të së vërtetës në Kroaci. Për dallim, vetëm përpjekje të kufizuara janë bërë nga autoritetet kroate për të vënë në pah publikisht dhe ti publikojnë faktet që rrethojnë ngjarjet që kanë ndodhur gjatë luftës në territorin e Kroacisë gjatë viteve të 90-ta. Në mars të vitit 2005, një qendër zyrtare e quajtur Qendra Memoriale dhe Dokumentacionit në Luftën Mbrojtëse për Atdhe ishte themeluar për të grumbulluar dhe përpunuar dokumentacionin përkitazi me luftën. Qendra, parashihej si “institut publik shkencor”, po ashtu planifikon të kryej hulumtime lidhur me çështje të ndryshme të luftës.¹²⁹ Është e rëndësishme të theksohet, megjithëse, që historiani Ante Nazor, drejtor i Qendrës, e ka bërë të qartë se ai beson se “Lufta për Atdhe” është njëra prej periudhave më të rëndësishme të Kroacisë, dhe se Operacioni Shkreptima dhe Furtuna ishin veprime ligjore dhe legjitime nga ushtria e Kroacisë për të çliruar territoret e okupuara.¹³⁰

Rezultati i luftës në vend fillimisht ishte perceptuar si fitore e mbrojtësve në “Luftën e Atdheut” mbi agresorët serb. Kjo, e kombinuar me kontekstin e veçantë të pas luftës të shënuara me zhvillim ekonomik dhe me lidhje relativisht të afërta me Perëndimin, i ka lejuar shtetit të shmang konfrontimin serioz dhe të paanshëm me të kaluarën e saj. “Deklarata e Luftës Patriotike”, e miratuar nga Parlamenti në tetor të vitit 2000, është një shembull i kësaj. Deklarata thotë që, “Republika e Kroacisë ka zhvilluar një luftë të drejtë dhe legjitime, mbrojtëse dhe çlirimtare, dhe jo luftë agresore dhe okupuese kundër ndokujt, në të cilën ajo mbrojti territorin e saj nga agresori i madh serb përbrenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtar”. Gjersa nuk e mohon në mënyrë të qartë ndonjë krim të luftës të kryer nga forcat kroate, si një deklaratë zyrtare ajo konfirmon një pasqyrë të pakompletuar të luftës, pasi që nuk ka pranimit ekuivalent zyrtar të spastrimit etnik kundër civilëve serb etnik. Posaçërisht gëzon fakti lidhur me këtë që të gjitha paditë e Tribunalit të Hagës kundër të akuzuarve kroat për krime gjatë “Luftës për Atdhe” – që do të thotë

¹²⁸ Kruhonja, K. (Ed.), “Monitorimi i Gjykimeve të Krimeve të Luftës. Raporti Vjetor 2005”, Osijek, Qendra për Paqe, Pa dhunë dhe për të Drejtat e Njeriut, 2005, p. 10 dhe Misioni i Kroacisë në Kroaci, Raporti Statusor No.17 mbi Progresin Kroat në Pëmbushjen e Angazhimeve Ndërkombëtare që nga korriku 2005” 10 nëntor 2005, p. 16.

¹²⁹ “Në gjurmim të vërtetës për Luftën për Atdhe”, Ushtari Kroat, 7 shkurt 2006, në dispozicion në <http://www.hrvatski-vojniki.hr/hrvatski-vojniki/0722006/nazor.asp>

¹³⁰ “Hulumtimi i luftës për Atdhe pa monopol”, *Nedjeljni Vjesnik*, , 24 prill 2006

ato kundër Norac dhe Ademi, Markač Čermak, Gotovina, dhe Bobetko – supozon jo vetëm kryerjen e krimeve nga ushtria kroate, por ekzistencën e Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale, anëtar të së cilës shtrihen në postet më të larta të shtetit kroat. Megjithatë, sipas studimit të UNDP-së, “Deklarata mbi Luftën për Atdhe”, në shtesë të faktit që ajo është ligjërish e vlefshme, po ashtu reflekton konsensusin e përgjithshëm të opinionit publik në vend.¹³¹ Në këtë masë, duket se ka pak gatishmëri publike ose zyrtare për të pranuar dhe për të marr përgjegjësin për shënimet e nuancuara dhe historikisht komplekse të rolit të vet Kroacisë.

Përveç kontributeve të rëndësishme por të kufizuara të gjykimeve në Tribunal të Hagës dhe në gjykatat vendore në themelimin e fakteve të caktuara që lidhen me luftën, përpjekjet më të dukshme në kërkimin e së vërtetës janë ndjekur nga OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare. Këto OJQ kanë luajtur rol vendimtar në përpilimin e dokumenteve dhe grumbullimin e dëshmimeve të viktimave, dhe ata kanë ndihmuar krijimin e hapësirës për debate publike në keqtrajtimet e kaluara të drejtave të njeriut në vend. Megjithatë, në lidhje me perspektiven e krijimit të mekanizmit më formal siç është komisioni i së vërtetës, OJQ-të e kanë pranuar për shume kohë, siç e shpreh njëri prej përfaqësuesve të tyre kryesor, që “nuk ka absolutisht mundësi që Parlamenti ta përkrah atë, dhe ne nuk kemi përkrahje publike”.¹³² Njëra prej arsyeve të dhëna për këtë situatë është fakti që, ndryshe nga Bosnja dhe Serbia, Kroacia fitoj luftën e vet. Një veteran i angazhuar në përpjekjet për ndërtimin e paqes tha, Ne jemi fituesit e luftës. Tregimi i kësaj poeme epike [njëra prej tyre] mbulohet me lavd. Pra çfarë tjetër mund të thuhet për atë? Kushdo që shpreh kritika është i dyshuar lidhur me motivet e tij.”¹³³ Rrjedhimisht, OJQ-të lokale siç është *Documenta* kanë drejtuar përpjekjet e tyre në grumbullimin e informacionit dhe promovimin e iniciativave të gjetjes së fakteve. Në kryerjen e kësaj pune, ata janë fokusuar fuqimisht në qasjen rajonale të kërkimit të vërtetës – për të dyja, si për mungesë të progresit në nivelin kombëtar dhe po ashtu për shkak të dinamikës rajonale që ka luajtur rol në konflikt.¹³⁴

Raportet e mediave të publikuara nga mediat kyçe të pavarura , përfshirë *Feral Tribune*, kanë qenë guximtar në ngritjen e debatit publik lidhur me çështjen e krimeve të kaluara, posaçërisht ato krime të kryera kundër serbëve. Këto media të hapura kanë luajtur një rol të dobishëm në ngritjen e vetëdijes dhe në shtyrjen për përgjegjësi të atyre që janë përgjegjës.

Për shumë vite, lista zyrtare kroate e të zhdukurve reflektonte vetëm viktimat kroate. Në bashkëpunim me Komitetin e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, qeveria ndërmori një projekt në përpilimin e një liste të vetme të personave të zhdukur, kështu që zëvendësoj dy listat

¹³¹ UNDP, “Drejtesia Kalimtare: Analizë e Vlerësimeve të Kushteve në Ish Jugosllavi”, Beograd 2006, p. 154.

¹³² Intervistë e ICTJ me përfaqësuesit e OJQ-ve 23 dhjetor 2005.

¹³³ Intervista e ICTJ me veteranin e luftës, 23 dhjetor 2005.

¹³⁴ *Documenta* – Qendra që Merret me të Kaluarën nënshkroi “Protokollin mbi bashkëpunimin rajonal për qëllim të hulumtimit dhe dokumentimit të krimeve të luftës në vendet e pas Jugosllavisë”, në partneritet me Qendrën Kërkimore dhe Dokumentues nga Sarajeva dhe Qendrën Ligjore Humanitare me seli në Beograd.

ekzistuese, kryesisht listat një etnike, – një nga 1991/92 dhe tjetra nga 1995.¹³⁵ në mars të vitit 2006, qeveria arriti një marrëveshje me Bosnjë-Hercegovinën dhe Serbinë dhe Malin e Zi mbi një seri të listave me emra të përafërsisht 2500 personave të zhdukur.¹³⁶ Komiteti i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar tregoi se do të konsolidoj këto lista në një publikim të vetëm të emëruar, “Libri i të Zhdukurve”, me një datë të pritshme të botimit në fund të vitit 2006.¹³⁷ në të njëjtën kohë, në korrik 2005 qeveria miratoi dekretin mbi themelimin e komitetit për personat e burgosur dhe të zhdukur që të shërbej si organ konsultativ për qeverinë.¹³⁸ Mosmarrëveshjet dhe mungesa e bashkëpunimit në mes të asociacioneve të serbëve dhe kroatëve për personat e zhdukur, si rezultat i kuptimeve të ndryshme nga e kaluara dhe ndarjet e dëshmuara të fuqishme në shoqëri, janë ende të thella dhe sjellin pengesa serioze në procesin e kërkimit të vërtetës.¹³⁹

III. KOMPENSIMI

A. Kompensimi material

Çeshtja e kompensimeve në Kroaci ka konsistuar kryesisht në adresimin e shkeljeve të të drejtave pronësore, punë kjo ngushtë e lidhur me kthimin e refugjatëve. Kompensimet për pronat e dëmtuara apo të humbura janë prekur në një masë të madhe nga masat e aprovuara nga shteti dhe, ne disa raste, përmes ankesave për dëme të sjellura para gjykatave vëndore dhe ndërkombetare. Mungesa e politikës së vazhdueshme të qeverisë nënkupton që Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vazhdon të jetë një forum i rëndësishëm ku këto mosmarrëveshje ligjore të gjata vendosen.¹⁴⁰

¹³⁵ Misioni i OSBE-së në Kroaci “2006 Raporti Rishikues mbi Progresin Kroat në Përmirësimin e Angazhimeve Ndërkombëtare që nga viti 2001, 9 korrik p. 19.

¹³⁶ Komisioni qeveritar për personat e Burgosur dhe të Zhdukur, “Raporti për Personat e Zhdukur dhe të Burgosur (janar 2004- mars 2006)”, në dispozicion në <http://ëëë.vlada.hr/download/2006/03/09/147-3.pdf>.

¹³⁷ Misioni i OSBE-së në Kroaci, “2006 Rishikim”, 9 korrik 2006, p.26.

¹³⁸ Bashkëpunimi ndër shtetëror në fushën e personave të zhdukur mund të përmirësohet duke marr parasysh garancitë e fundit të Kroacisë dhe Serbisë për ti bashkuar përpjekjet në përshejtimin e procesit. Shiko “Kroacia, Serbia-Mali i Zi të intensifikojnë përpjekjet për qartësimin e fatit të personave të zhdukur”, *Southeast European Times*, 3 shkurt 2006, në dispozicion në http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/newsbriefs/setimes/newsbriefs/2006/02/03/nb-05.

¹³⁹ Shifrat e ofruara nga asociacionet Kroate dhe Serbe për personat e zhdukur ndryshojnë vazhdimisht dhe shpesh janë konfuze. Numri i përgjithshëm i Serbëve të Kroacisë të zhdukur që pretendohet nga organizata me seli në Beograd Veritas është 2805. Shiko “Regjistrin” Veritas, në dispozicion në <http://www.veritas.org.yu/engleski/listings.htm>. Kjo shifër është përsëritur nga organizata simotër e Veritas, Asociacioni i Personave Serb të Zhdukur me seli në Vukovar, e cila është vetmja e llojit të vet në Kroaci. Aleanca për Ushtarët dhe Personat e Zhdukur me seli në Zagreb 1991-96, pretendon që 1043 persona janë të zhdukur nga viti 1991 (përfshirë 200 Serb dhe 400 luftëtar Kroat), dhe vë numrin e personave të zhdukur pas vitit 1995 në 2023 (Kroat dhe Serb). KNKK llogarit numrin e personave të zhdukur nga Operacioni Stuhia në vitin 1995 në mes të 850 e 900 personave. Sipas raportit të fundit të Komisionit Qeveritar që mbulon periudhën nga 1 janari 2004 gjer më 1 mars 2006, 1140 Kroat janë ende të zhdukur dhe 915 Serb.: <http://www.vlada.hr/Download/2006/03/09/147-3.pdf>.

¹⁴⁰ Një hap i rëndësishëm drejt bashkëpunimit rajonal në adresimin e çeshtjes së kthimit të refugjatëve është ndërmarrë përmes aprovimit të Deklaratës Ministrore për Kthimin e Refugjatëve nga qeveritë e Bosnjë Hercegovinës, Kroacisë dhe Serbisë e Malit të Zi në Sarajevë më 31 Janar 2005, e njohur si “Procesi i Sarajevës në Kthimin Rajonal të Refugjatëve”, me objektiv të “zgjidhjes së çeshtjeve të mbetura përmes

Midis 300,000 dhe 350,000 serb të Kroacisë është vlerësuar që kanë lëshuar shtëpitë e tyre në Kroaci gjatë luftës.¹⁴¹ Sipas Organizatës për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë (OSBE), prej prillit 2006, mbi 120,000 nga 300,000 serb të Kroacisë dhe 218,000 nga 221,000 kroat jövullnetarisht të zhvendosur gjatë luftës janë kthyer në Kroaci.¹⁴² Politikat e qeverisë kroate sa i përket kthimit të refugjatëve dhe kompensimit të shkeljeve të të drejtave pronësore janë përmbyllur me kthimin e pronës, rindërtimin e pronës së dëmtuar apo shkatërruar¹⁴³ dhe formimin e programeve për kujdes banesor drejtuar në ish mbajtësit e të drejtës së banimit/qiradhënjës. Procesi i kthimit të pronës pritet të përfundoj në 2006. Midis 1995 dhe 1998, përafërsisht 19,500 shtëpi private që u përkasin serbëve të Kroacisë kanë qënë përkohësisht të alokuara për përdorim për persona tjerë nga shteti kroat, kryesisht për refugjatët kroat të Bosnës. Sipas OSBE-së, prej prillit 2006, si rezultat i përpjekjeve për kthim, vetëm 219 të këtyre shtëpive mbesin të banuara nga përdoruesit e përkohëshëm.¹⁴⁴

Sa i përket rindërtimit të shtëpive private të dëmtuara apo shkatërruara, është raportuar se deri në fund të vitit 2003 qeveria kroate ka rindërtuar 123,000 njësi banimi,¹⁴⁵ ku përfituesit kryesor kanë qënë aplikantët kroat.¹⁴⁶ Vetëm nga ajo kohë serbët e Kroacisë janë bërë përfitues të rendësishëm, edhe pse pas vazhdimit të afatit kohor për dorëzimin e kërkesave për rindërtim, në fund të 2005 kanë mbetur ende 6500 kërkesa të pazgjdhura dhe 12,000 ankesa.¹⁴⁷

Mbase sfida e tashme më e madhe e ballafaquar nga qeveria kroate në këtë fushë është çeshtja e ish mbajtësve të drejtës për shfrytëzim/banim, *p.sh.*, njerëzit që kanë jetuar në banesat prona të shtetit dhe që kanë ikur gjatë apo pas luftës.¹⁴⁸ Ky është rasti për

časjes së bashkërenduar rajonale”. Shih, përshembull, BBC, “Krizë Ballkanike e refugjatëve lehtësohet”, 18 Mars 2005, në dispozicion tek <http://news.bbc.co.uk/1/hi/world/europe/4360555.stm>.

² Human Rights Watch, “Raporti Botëror 2005”, Jan. 2005, fl. 364-368.

¹⁴² Të dhëna nga UNHCR dhe Zyrja për Refugjatë dhe Persona të Zhdukur publikuar në Misionin e OSBE-së në Kroaci, “2006 Raporti i Rishikimit mbi Progresin e Kroacisë në Takimin e Përkushtimeve Ndërkombëtare prej 2001”, 9 Qershor 2006 f. 13. Sidoqoftë, është gjërësisht e besuar së këta numra nuk reflektojnë *de facto* numrin e të kthyerve që jetojnë në Kroaci, pasi që shumë nga ta janë kthyer në Serbi e Mal të Zi apo Bosnjë-Hercegovinë pasi që njëherë janë regjistruar zyrtarisht në Kroaci.

¹⁴³ Ndihma në Rindërtim ishte e rregulluar me Ligjin për Rindërtim 1996 (*Gazeta popullore*, nr. 24/1996, 26 Mars, 1996). Në mënyrë që të adresohen kërkesat që ky ligj ishte “diskriminues” kundër Serbëve Kroat, është plotësuar në 2000 (*Gazeta popullore*, no. 57/2000, 9 Qershor, 2000). Sipas verzionit të plotësuar, ky ligj “rregullon rindërtimin e të mirave materiale të shkatërruara apo dëmtuara në Republikën e Kroacisë të cilat ishin të ekspozuara aktivitetëve destruktive dhe efekteve nga fillimi i agresionit të Madh Serb deri të kompletimi i reintegrimit paqësor [Januar 1998]”. Shiko Human Rights Watch, “Premtimet e Thyera: Pengesat për Kthimin e Refugjatëve në Kroaci”, Shtator. 2003, Kap. 15, Nr. 6 (D), f. 45

¹⁴⁴ Si pjesë e këtij procesi, qeveria ka siguruar banim alternativ për përdorues të përkohëshëm dhe është zotuar të kompenzoj pronarët për dëmët e pronave që kthehen përmes ndihmës në riparim apo granteve në kesh organizatë nga shteti. Shiko OSBE Misioni në Kroaci, “2006 Raporti i Rishikimit mbi Progresin e Kroacisë në Takimin e Përkushtimeve Ndërkombëtare prej 2001”, 9 Qershor 2006 f. 15.

¹⁴⁵ Njësia e Intelegjencës së The Economist, “Profili i Vendit 2004: Kroacia”, Londër, 2004, f. 19.

¹⁴⁶ Në 2003 tre të katërtat e shtëpive të rindërtuara ishin të të kthyerve Serb. Ibid.

¹⁴⁷ Misioni në Kroaci, “Raporti i Statusit Nr.17 mbi Progresin e Kroacisë në Takimin e Përkushtimit Ndërkombëtar prej Korrik 2005”, 10 Nëntor, 2005, f. 7.

¹⁴⁸ BE ka nënvizuar se “ka pasur zhvillime positive në kthimin e refugjatëve por progresi ka qënë veçanërisht i dobët në implementimin e programeve të kujdesit të banimit për ish mbajtësit e të drejtës së

shumicën e refugjatëve të mbetur dhe personave të zhvendosur brenda të cilët ende nuk kanë çasje në banim.¹⁴⁹ Sipas Aktit Banesor Kroat të vitit 1985 dhe serisë së ligjeve pauese, shteti lejohet ti jap fund të drejtës për shfrytëzim/banim të atyre që kanë lëshuar shtëpitë e tyre dhe nuk janë kthyer për gjashtë muaj.¹⁵⁰ Paradoksalisht, përderisa ka ende procedime gjyqësore në veprim në gjyqet vendore për dhënien fund të këtyre të drejtave, qeveria ka aprovuar programe për përkujdesje banesore,¹⁵¹ të cilat kanë filluar ngadalë të implementohen.¹⁵²

Një rast i sjellur para Gjykatës Evropiane për të Drejtat të Njeriut në lidhje me këtë çështje, *Blçiq v. Kroacisë*, është bërë veçanërisht e famëshme për shkak të protestave të organizatave për të drejtat e njeriut kundër vendimit të gjykatës në korrikut të vitit 2004. Aplikanti, refugjat serb nga Kroacia, ka patur të ndërprerë të drejtën e qiradhënjes me arsyen se ka munguar në apartamentin e saj për më tepër se gjashtë muaj pa ndonje arsye të ligjshme. Dhoma e shkallës së parë e Gjykatës Evropiane ka mbeshtetur vendimin e gjyqit kroat se ndërprerja e të drejtës së qiradhënjes ka qënë e arsyeshme, dhe përderisa kjo është sfiduar më pas përmes apelit, është refuzuar së fundi në bazë procedurale. Përderisa rasti është parë nganjëherë si mbeshtetje e legjitimitetit të legjislacionit banesor relevant (përfshirë Aktin Banesor të 1985) duhet të përmendet se vendimi ka qënë i kufizuar në rastin konkret dhe jo në skemën legjislative si tërësi. Sidoqoftë, vendimi është kritikuar për ndikimin negativ në procesin e kthimit të refugjatëve.¹⁵³

Në 2003, qeveria kroate aprovoi dy ligje që adresojnë dëmët jo-pronësore të kohës së luftes: *Ligji për përgjegjësitë për dëmët e shkaktuara nga aktet terroriste dhe demonstratat publike*¹⁵⁴ (“Ligji për Dëmët Terroriste”) dhe *Ligji për përgjegjësinë e Republikës së Kroacisë për dëmët e shkaktuara nga anëtarët e Forcave të Armatosura të Kroacisë dhe policies gjatë Luftës Atdhetare* (“Ligji për Dëmët e Forcave të

qiradhënies”. Shiko BE, “Të gjeturat themelore të Raportit të Progresit për 2005 në Kroaci”, 9 Nëntor, 2005.

¹⁴⁹ Misioni në Kroaci, “Raporti i Statusit Nr.17 mbi Progresin e Kroacisë në Takimin e Përkushtimit Ndërkombëtar prej Korrik 2005”, 10 Nëntor, 2005, f.6.

¹⁵⁰ Akti i Banimit të 1985 (*Zakon o stambenim odnosima*, Gazeta Zyrtare no. 51/1985, 42/1986, 22/1992, 70/1993). Shiko poashtu: “Ligji për marrjen e përkohëshme dhe Administrimi i Pronës Specifike” (*Zakon o privremenom preuzimanju i upravljanju određenom imovinom*, Gazeta Zyrtare 73/1995, 7/1996, 100/97) dhe “Ligji mbi Qiradhënien e Banesave në Territorët e Çliruarat” (*Zakon o najmu stanova na oslobođenim područjima*, Gazeta Zyrtare no. 73/1995, repealed 101/1998).

¹⁵¹ Këto programe parashohin mundësinë e ish mbajtësve të DOQ-ve në qytetet e caktuara të mëdha “të lëshojnë me qira apo të blejnë apartamente të ndërtuara nga shteti nën çmimin e tregut”. Shiko Human Rights Watch, “Raporti Botëror 2005”, Jan. 2006, f. 364-368 dhe OSBE Misioni në Kroaci, “Raporti i Statusit Nr.17 mbi Progresin e Kroacisë në Takimin e Përkushtimit Ndërkombëtar prej Korrik 2005”, 10 Nëntor, 2005, f.6..

¹⁵² Vetëm disa ish mbajtës të DOQ kanë përfituar nga këto programe deri në Nëntor 2005. Human Rights Watch, “Raporti Botëror 2006”, Jan. 2006, f. 347-351.

¹⁵³ *Blçiq v. Kroacisë*, Apl. Nr. 59532/00. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“GEDN”) mbeshteti vendimin e gjyqit Kroat për ti dhënë fund të drejtës për qiradhënie të aplikuesit, i cili e kishte lëshuar shtëpinë e saj në Zarë me 1991 dhe nuk është kthyer Brenda gjashtë muajsh periudhë e përshkruar nga ligji Kroat. Tek dëgjimi i ankesës me 8 Mars, 2006, GEDN vendosi që rasti ishte i papranueshëm për arsyen se ishte jashtë juridiksionit të përkohëshëm të GEDN-së, dhe nuk ka proceduar të determinoj meritat e kërkesës që e drejta e aplikantit për zotërim është shkelur.

¹⁵⁴ *Narodne novine* [Gazeta Zyrtare], Nr. 117/2003.

Armatosura”).¹⁵⁵ Dispozitat e këtyre dy ligjeve dhe lidhja e tyre me ligjet mbi dëmët pronësore kanë nxitur kritika nga individët dhe orgaizatat për të drejtat e njeriut dhe kanë shaktuar dyshime për potencialin e tyre për ofruar riparime efektive viktimeve dhe të afërmëve të tyre. Arsyeja për polemikë mbështetet në faktin se *Ligji për Dëmët Terroriste* aplikohet vetëm në rastet e lëndimeve personale dhe deklaron se të gjitha dëmët materiale duhet të kompensohen në pajtim me *Ligjin për Rindërtim*. Pasi që i fundit përjashton nga fushëveprimi i tij rastet në të cilat prona është dëmtuar apo shkatërruar nga “aktet terroriste” (p.sh. aktet të cilat nuk janë kryer nga njëra nga palët ndërluftuese), shumë individ të cilëve prona u është dëmtuar janë lënë pa ndonjë kompenzim ligjor.¹⁵⁶ Këto brenga janë adresuar pjesërisht nga vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin e *Zadro v. Kroacisë*,¹⁵⁷ i cili është përmbyllur duke thënë se procedimet në bazë të *Ligjit për Rindërtim* dhe atyre në bazë të *Ligjit mbi Dëmët Terroriste* do të konsiderohen ndaras, duke kuptuar se të hershmët janë të natyrës administrative dhe të vonshmet janë të natyrës gjyqësore. Kjo do të thotë se kompenzimi i lidhur me pronën mund të kërkohet paralelisht me kompenzimin për lëndime personale. Një kritikë tjetër është hedhur kundër *Ligjit për Dëmët e Forcave të Armatosura*, i cili mëton të ofroj një definicion më të ngushtë për “dëmtim” – duke limituar përgjegjësinë e shtetit në krahasim me formulimin e *Ligjit mbi Marrëdhëniet Obligative* të vitit 1996.¹⁵⁸

Individët kanë ushtruar kërkesa kompenzimi në procedure civile para gjykatave vendore. Në disa raste, kompenzimi u është caktuar të mbijetuarve serb për vrasjet e qëllimta në procedurat kundër anëtarëve të armatës kroate dhe forcave të policisë.¹⁵⁹

Në nivel ndër-shtetëror, me 1999, Kroacia ka parashtruar kërkesa kompenzimi në Gjykatën Nderkombëtare të Drejtësisë kundër Republikës Federale të Jugosllavisë për shkeljet e Konventës mbi Parandalimin dhe Denimin e Krimeve të Gjenocidit, pretenduar që janë bërë midis viteve 1991 dhe 1995.¹⁶⁰ Një padi e ngajshme është paraqitur nga Bosnja dhe Hercegovina kundër Serbisë e Malit të Zi do të ofroj një test crucial për aplikacionin e Kroacisë.¹⁶¹ Vendimi i Gjykatës pritet në fillim të 2007. Në zhvillimet interesante të fundit, Kroacia dhe Mali i Zi nënshkruan marrëveshje bilaterale me 27 korrik 2005, sipas të cilës Mali i Zi zotohet për pagesën e kompensimit prej 400,000 eurove Kroacisë për shkatërrimin e fermave gjatë luftës në rajonet afër kufirit.¹⁶²

¹⁵⁵ *Narodne novine* [Gazeta Zyrtare], Nr. 117/2003.

¹⁵⁶ OSBE Misioni në Kroaci, “Udhëzimet për të kthyerit në Kroaci”, Dhjetor. 2004.

¹⁵⁷ *Zadro v. Kroacisë*, Apl. Nr. 25410/02, Vendimi i 26 Majit, 2005.

¹⁵⁸ Shiko OSBE Misioni në Kroaci, “Udhëzimet për të kthyerit në Kroaci”, Dhjetor. 2004.

¹⁵⁹ Në vijim janë shembujt e rasteve të tilla: *Skendzhiq v. Republika e Kroacisë* and *Karleusha v. Republika e Kroacisë*, Të dyjat në Gjykatën Komunale të Otoçac, and *Ljubiçiq v. Republika e Kroacisë* në Gjykatën Komunale të Kroacisë.

¹⁶⁰ Lista e Përgjithshme e GjND Nr. 118. Shiko GjND, Komunikatë për Shtyp 99/38, 2 Korrik, 1999. Teksti i aplikacionit është në dispozicion në http://www.icj-cij.org/icjwww/idocket/icry/icry_orders/icry_iapplication_19990702.PDF.

¹⁶¹ Rasti në lidhje me Aplikimin e Konventës mbi Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit (Bosna e Hercegovina v. Serbisë dhe Malit të Zi), Gjyqi Nderkombëtar i Drejtësisë. Lista e Përgjithshme e GND Nr. 91. Për më tepër informata shiko <http://www.icj-cij.org/icjwww/idocket/ibhy/ibhyframe.htm>.

¹⁶² Southeast European Times, “Kroacia, Mali i Zi pritet të arrijnë marrëveshje për pagesën e kompensimit të kohës së luftës”, 27 Korrik, 2005, në dispozicion http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/document/setimes/newsbriefs/2005/07/27/nb-06.

B. Faljet publike

Si shtesë e kompensimit të paguar, ka një rritje të njohjes se masat riparuese mund të përfshijnë, mes gjërave tjera, pranim zyrtar dhe faljet për gabimet në të kaluarën.¹⁶³

Sa i përket luftës në Kroaci, kanë qënë dy instanca të faljes publike. Me 25 qershor 2000, Kryetari i Malit të Zi, Milo Gjukanoviq, i kërkoj falje Kroacisë për përfshirjen e shtetasve të tij në bombardimin e Dubrovnikut me 1991.¹⁶⁴ Me 10 shtator 2003, Kryetari i Kroacisë, Stjepan Mesiç, gjatë vizitës së pare pas luftës në Beograd, ka shkëmbyer kërkim falje me Kryetarin e Unionit të Serbisë dhe Malit të Zi, Svetozar Maroviq, për veprimet e qytetarëve të tyre gjatë konfliktit 1991-95.¹⁶⁵ Të dy kërkim faljet joshën debat publik të konsideruar. Disa i mirëpritën komentet si gjest historik të rëndësishëm; të tjerët theksuan se faljet nuk kanë kuptim perderisa kryesit e krimeve mbahen në përgjegjësi dhe e vërteta pranohet zyrtarisht. Edhe pse thjesht çështje protokoli, kërkim faljet duket të kenë kontribuar normalizimit të marrëdhënieve në mes shteteve.¹⁶⁶

IV. MEMORIALET

Në mënyrë që të tregohet respekt për përkujtimin dhe vuajtjet e viktimave të luftës, një numër memorialeve është ndërtuar në Kroaci, shumica e tyre duke nderuar viktimat kroate. Sipas Aleancës për Ushtarët dhe Personat e Zhdukur e udhëhequr nga kroatët, 47 monumente të tilla janë ndërtuar tash më. Ato përfshijnë ato të luftëtarëve, siq është ai Varrezave Memoriale të Viktimave të Luftës Atdhetare në Vukovar, dedikuar atyre që rezistuan dhe vdiqën gjatë rrethimit serb tre-mujor të qytetit.¹⁶⁷ Disa nga memorialet janë ngritur në vendet ku krimet e luftës janë kryer. Me siguri se më mire i njohur në mesin e këtyre është memoriali në fermën e Ovqarës, afër Vukovarit, ku mbi 200 kroat, kryesisht pacientë të spitalit, janë vrarë nga ushtarët serb në 1991.

¹⁶³ Shiko të aprovuar se fundi “Principet themelore dhe udhëzimet për të drejtën për të rregulluar riparimin e viktimave të shkeljeve të mëdha të ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe shkeljet serioze të ligjit ndërkombëtar humanitar”, Rezoluta për të Drejtat e Njeriut, 2005/35, në dispozicion tek http://ap.ohchr.org/documents/E/CHR/resolutions/E-CN_4-RES-2005-35.doc.

¹⁶⁴ Tranzicionet Online, “Faljet Gjithandej”, 18 Shtator, 2003, në dispozicion tek <http://www.tol.cz/look/BRR/article.tpl?IdLanguage=1&IdPublication=9&NrIssue=1&NrSection=6&NrArticle=10672>.

¹⁶⁵ Kryetari Maroviq deklaroi, “Në emer të së kaluarës që ne nuk mund ta ndryshojmë, Unë, si Kryetar i Serbisë dhe Malit të Zi, këkoj falje për të gjitha të këqijat që qytetarët e vendit tim i kanë bërë kujtdo në Republikën e Kroacisë”. Kryetari Kroat pranoi kërkimfaljen dhe ofroj të tijën: “Unë kërkoi falje të gjithë atyre të cilëve qyterarët e Kroacisë u shkaktuan dhimbje duke shkelur ligjin dhe abuzuar pozitën e tyre në cilën do kohë të periudhës”, BBC, “Kryetarët kërkonë falje rreth luftës Kroate”, 10 Shtator, 2003., në dispozicion <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/3095774.stm>.

¹⁶⁶ Intervistë me ICTJ, Korrik 2006.

¹⁶⁷ Vukovari përfundimisht ra në forcat Serbe me 18 Nëntor 1991. Shiko HRT, “14 Vjetori i Luftës Atdhetare të mundimshme në Vukovar”, 18 Nëntor, 2005, në dispozicion tek <http://vijesti.hrt.hr/ShowArticles.aspx?ArticleId=2672>.

Një memorial tjetër në Zagreb ka qënë subjekt i disa polemikave në 2005. Gjatë luftës, familjet e viktimave filluan të vendosin tulla, secila me emer të viktimës në të, në kalldrëmin para ndërtesës së OKB-së në kryeqytet. U bë e njohur si “muri i dhëmbjes” dhe ka mbetur që nga atëherë si memorial *ad hoc*. Në qershor 2005, gjatë bisedimeve në mes të autoriteteve lokale dhe organizatave të viktimave rreth ndërtimit të memorialit më formal, “muri i dhëmbjes” u largua papritmas nga autoritetet. Disa denoncuan mos ndjeshmërinë e autoriteteve dhe shprehën dhunë përderisa ca tulla u thyen gjatë procesit dhe nuk u përpilua asnjë listë me emrat e viktimave. Të tjerët pohuan se mediat manipuluan mbulimin e incidentit dhe se tullat në fakt do të ishin pjesë e një memoriali të ri, i cili do të jetë përfaqësim masiv i dyerve të hapura në të cilin “ka hapësirë të mjaftueshme për 14,000 emra.”¹⁶⁸

Vetëm një memorial për vrasjen e civilëve serb është e njohur të ekzistoj në Kroaci. Është me lokacion në fshatin Kistanje, afër Varivode në Dalmaci, ku rreth 10 civil serb të Kroacisë janë vrarë në gusht të 1995.¹⁶⁹ Deficiti i memorialeve për civilët serb demaskohet çka është një trend i madh në Kroaci, rezistent kryesisht në nocionin se kroatët kanë bërë ndonjë krim lufte.¹⁷⁰ Në këtë kuptim, shumica e memorialeve ekzistuese shërbejnë më tepër si haraç festues për fitoren në “Luftën Atdhetare” se si kontribute të falenderimit të përbashkët të së kaluarës. Në menyre të ngjajshme, Fitorja dhe Dita e Falenderimeve Atdhetare festohet si festë publike kombëtare me 5 gusht, duke shënuar datën e vitit 1995 kur qyteti i Kninit është ri-marrë nga Operacioni Stuhia. Përkundër faktit të shkatërrimeve të mëdha nga forcat kroate të shtëpive të serbëve të cilët u larguan, dhe vrasjes së qindra civilëve të moshuar të cilët mbetën mbrapa, udhëheqësit e shtetit vazhdojnë të përjetësojnë verzionin heroic zyrtar të luftës, duke vazhduar se vetëm individ mashtrues kanë qënë përgjegjës për krimet kundër jo-kroatëve.¹⁷¹

V. VERIFIKIMI DHE REFORMAT TJERA INSTITUCIONALE

Nuk ka patur përpjekje për verifikime sistematike publike në forcat e sigurisë kroate ose në sferën politike apo të drejtësisë. Në vend, me tepër çasje jo-formale është zgjedhur për tu marrë me individ supozuar të jenë të implikuar në abuzimet e kaluara dhe mbajtur pozita në forcat e armatosura, polici, apo drejtësi. Ky proces i verifikimit jo-formal mori formën e pensionimit, zëvendësimit apo thjesht ri-caktimit.¹⁷² Në nivelin politik, sidoqoftë, nuk ka patur përpjekje të ngjajshme për të larguar individët të cilët kanë mundur të jenë të involvuar në abuzime në të kaluarën. Më tutje, njëanshmëria etnike në drejtësi

¹⁶⁸ Intervista e ICTJ me Aleancën (Kroate) për persona të zhdukur, Zagreb, 22 dhe 23 Dhjetor, 2005.

¹⁶⁹ Intervista e ICTJ me liderët politik Serb, Zagreb, 19 Dhjetor, 2005.

¹⁷⁰ UNDP, “Drejtësi e Përkohëshme: Anketë Vlerësimi për Kushtet në Ish-Jugosllavi”, Beograd, 2006, f. 154.

¹⁷¹ HINA Agjenci e Lajmeve, 5 Gusht, 2006, “Kryetari Kroat thotë se Krimet e Operacionit Stuhia u Kryen nga Individët”.

¹⁷² Si shembull i kuotuar shpesh i kësaj në intervistat me ICTJ është ish kryetari i Gjykatës Supreme, Milan Vuković i cili deklaroi se ishte e pamundur të kryhen krime lufte në luftë mbrojtëse. Ai me vonë është levizur në Gukatën Kushtetuese i cili, përderisa nuk u largua nga zyra, ishte parë si masë të qetë të ri-caktimit të tij në një pozitë më pak prominente në të cilën ai nuk do të mundte më të vendos për rastet e krimeve të luftës

(detajuar me lartë) është trashëgim i 1990-ave të hershme, kur jo-nacionalistët dhe jo-kroatët nuk janë ri-emëruar në postet në drejtësi. Ajo trashëgëmi ka lënë mungesë të pakicave kombëtare në drejtësi. Në 2004, pakicat kombëtare përfaqësuan vetëm 5,4 përqind të gjykatësve në gjykatat kroate.¹⁷³ Edhe në fund të vitit 2005, serbët e Kroacisë kanë përbërë vetëm 2,4 përqind të stafit të drejtësisë kroate, ku, sipas regjistrimit të 2001, ata përbëjnë 4,5 përqind të popullsisë së përgjithshme.¹⁷⁴

Megjithatë, këto probleme duhen të shihen në kontekst më të gjërë të reformës institucionale që ka ndodhur në Kroaci, dhe ka qënë faktor i rëndësishëm në progresin e Kroacisë drejt arritjes së standarteve ndërkombëtare të kërkuara për anëtarësim në BE. Për shembull, forcat e policisë dhe drejtësia kanë shkuar nëpërmes një procesi gradual të reformës. Edhe pse pavarësia e drejtësisë Kroate shpesh është vënë në pikëpyetje,¹⁷⁵ strategjia për reformën e drejtësisë është aprovuar në Shtator 2005,¹⁷⁶ dhe amandamentet e dy ligjeve, Ligjit mbi Këshillin Shtetëror të Drejtësisë (trup që është përgjegjës për emërimin dhe disiplinimin e gjyqëtarëve) dhe draft ligjit në provizionet e ndihmës ligjore janë në diskutim e sipër.¹⁷⁷ Paralelisht, qeveria ka elaboruar një “Hartë Rrugore” për të reformuar forcat e policisë, për të cilën llogaritë në ndihmën e OSBE-së për të dhënë tranime dhe këshilla.¹⁷⁸ Sidoqoftë, dështimi për të rishikuar me kritikë përbërjen e drejtësisë, forcave të armatosura dhe policisë është me tutje dëshmi e mosvullnetit për të pranuar plotësisht krimet e kryera në emër të Kroacisë. Kjo mbetet një pengesë për një llogaridhënie të gjërë si dhe zhvillimin e besimit civil në institucionet shtetërore, veçanërisht për komunitetet pakicë të Kroacisë.

VI. PËRFUNDIM

Tribunali i Hagës ka përfunduar hetimet dhe nuk do të lëshoj padi të metutjeshme kundër individëve të dyshuar që kanë kryer krime lufte apo krime kunder njerëzimit në Ballkan gjatë viteve të hershme të 1990-ave. Sidoqoftë, kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme gjatë viteve të fundit pasi që vendet e ish Jugosllavisë kanë marrë përgjegjësitë për sjelljen në llogaridhënie të qindra të dyshuarve të kohës së luftës të cilët më parë i kanë ikur drejtësisë. Pasi që Dhoma e re e Krimeve të Luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë të fillojë gjykimet e sajë të para të mëdha në Sarajevë, dhe më Dhomën e Krimeve të Luftës

¹⁷³ “Komentet e Qeverisë së Kroacisë në Opinionin e Dytë të Komitit Këshillues mbi Implementimin e Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Kroaci”, 13 Prill, 2005, në dispozicion tek <http://www.minorityrights.org/admin/Download/pdf/CroatiaMicro2005.pdf>

¹⁷⁴ Departamenti i SHB – Biroja për Demokraci, Të Drejtat e Njeriut dhe Punës, “2005 Raporti për të Drejtat e Njeriut në Kroaci”, Mars 2006, në dispozicion tek <http://www.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2005/61642.htm>; CIA Libër faktesh: <https://www.cia.gov/cia/publications/factbook/geos/hr.html#People>

¹⁷⁵ Njësia e Intelejencës së The Economist, “Profili i Vendi 2004: Kroacia”, Londër, 2004, f. 14.

¹⁷⁶ Kjo reformë përfshinë masat në lidhje me Gjyqet Administrative dhe të tjera me tendencë të reduktimit këmbëngulës të rasteve të pakryera të cilat kanë qënë në bazat e shumë gjykatësve të GEDN në shkeljen e Kroacisë mbi të drejtën e gjykimin të drejta në kohë të arsyeshme. Shiko BE, “Të gjeturat themelore të Raportit të Progresit 2005 mbi Kroacinë”, 9 Nëntor, 2005 dhe OSBE Misioni në Kroaci, “Raporti mbi Statusin Nr.17 mbi Progresin e Kroacisë në Takimin e Perkushtimeve Ndërkombëtare prej Korikut 2005”, 10 Nëntor, 2005, f. 11.

¹⁷⁷ OSBE Misioni në Kroaci, “Raporti mbi Statusin Nr.17 mbi Progresin e Kroacisë në Takimin e Perkushtimeve Ndërkombëtare prej Korikut 2005”, 10 Nëntor, 2005, f. 11.

¹⁷⁸ Ibid, f. 19.

në Gjykatën e Qarkut të Beogradit tregojnë vullnet të ri për të zbatuar drejtësinë, Kroacia poashtu ka ofruar sinjale të vazhdueshme për tu kyqur në këtë përpjekje rajonale. Përkushtimi i rritur i udhëheqësve politik Kroat për të përfunduar mosndëshkimin në rajon ka, në masë të madhe, qënë për shkak të presionit të jokompromisit nga komuniteti ndërkombëtar dhe është mesazh i qartë se bashkëpunimi me Tribunalin e Hagës dhe ndjekja penale e krimeve të luftës në nivel kombëtar është e kërkuar pa kusht për pranim në Bashkimin Evropian. Në këtë drejtim të paktën, mund të thuhet se autoritetet Kroate janë të udhëhequra kryesisht nga pragmatizmi politik.

Megjithatë, progresi i qartë, sidoqoftë i ngadalëshëm, është bërë në drejtësinë Kroate për të ofruar gjykime të drejta dhe hetime efektive në shumicën e rasteve të ndieshme. Rritja e bashkëpunimit në mes të prokurorëve nga Kroacia, Serbia dhe Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina, shpesh në nivel jo-formal dhe me vetë iniciativë dhe jo si detyrim i politikës zyrtare, është zhvillim premtues në të dyja ndjekjen penale të krimeve të kaluara dhe zhvillimin e drejtësisë së pavarur në rajon. Megjithatë, ndjekjet penale vendore të krimeve të luftës kanë nevojë për forcim të mëtutjeshëm. Në veçanti, mbrojtja e deshtarëve ka nevojë të bëhet me efektive, instancat e njëanshmerisë etnike nevojitet të adresohet, dhe se sfidat e shkaktuara nga gjykimet *në mungesë* duhet të arriten.

Pavarësisht progresit të arritur në fushën e drejtësisë kriminale, pjesë të vendit, në veçanti rajonet më të prekura nga lufta siq është Vukovari, mbetet thellësisht i ndarë në vija etnike dhe keq-pregaditur, dhejtë vjet pas përfundimit të luftës, për tu përballur me trashëgiminë plotësisht. Kroacia ka ende të përballet me historinë përmes dialogut dhe debatit të hapur, përfshirë rishikimin e historisë së politizuar të konfliktit e cila është ende prezente shkollat Kroate. Presionet, kërcënimet dhe izolimet janë ende, shumë aktivistë të guximshëm të të drejtave të njeriut dhe gazetarë të cilët hetojnë dhe informojnë për krimet e bëra gjatë luftës (veçanërisht nëse pretendohet se janë bërë kundër ushtrisë Kroate) dhe mbi diskriminimet kundër pakicës etnike Serbe. Përpjekje serioze dhe zyrtare për të hetuar dhe publikisht pranuar krimet e të kaluarës ende mungojnë në Kroaci. Përpjekje të tilla mund të përfitojnë për të qënë të integruar, marrëveshje rajonale të kërkim-drejtësisë.

Çeshtja e kompensimit ka qënë objekt i programeve dhe legjislacionit të fundit të Qeverisë Kroate. Sidoqoftë, brengat mbasin mbi shumë raste të pa zgjidhura të pronave të yëna për të cilat, gradualisht, pak vëmendje po i kushtohet. Çdo zotim serioz për të siguruar kthim efektiv të refugjatëve duhet të sigurojë se kompensimet vazhdojnë të jepen në pajtim me standardet ndërkombëtare. Reforma institucionale, shumica e mbikqyrur deri me tani, do ti kontribuoj sigurimit të llogaidhënjës së gjërë për abuzimet e kryera dhe poashtu edhe në tejkalimin e vazhdimin të njëanshmërisë në funcionimin e institucioneve.

Në kontrast të shumë vendeve tjera të ish Jugosllavisë, Kroacia ka përfituar nga rruga relativisht e lehtë drejtë anëtarësimit në BE. Me Gotovinën tash në pritje të gjykimin në Hagë dhe bisedimet për hyrje në BE formalisht të nisura në tetor të 2005, presioni ndërkombëtar në Kroacinë tashmë është lehtësuar. Në të njëjtën kohë, shumica e përmirësimeve të detajizuara në këtë raport kanë qënë në masë të madhe ose për shkak të përshtatshmërisë politike në anën e qeverisë Kroate ose të përpjekjeve të organizuara

nga OJQ-të dhe individët. Ballafaqimi serioz në lidhje me paisjet ushtarake të të kaluarës së Kroacisë mbetet i pa cenuar. Dështimi i Kroacisë që plotësisht të ballafaqohet me abuzimet në të kaluarën mund të rrezikoj stabilitetin e paqes së saj dhe legjitimitetin e institucioneve të saj. Është pra esenciale që rruga e sukseshme e Kroacisë drejt pranimi në BE të mos hedh hije në të metat dhe pengesat me të cilat vendi ende ballafaqohet në veprimet e saj me abuzimet e kaluara. Për Kroacinë, qoftë brenda apo jashtë BE-së, një vlerësim i përgjithshëm mbi të kaluarën kështu mbetet sfidë dhe imperativ.